

DI
DRITA ISLAME

*Singeriteti,
thelbi i adhurimit*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 05 (480)
Maj, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Sinqeriteti dhe gjurma e tij në jetën e besimtarit / Mehmet Disha

6 Kuptimi dhe vlerat e Haxhit / H. Bujar Spahiu

8 Lajme / Aktivitete



12 Si duhet të jetë metoda e kumtimit ndaj një të riu? (I) / Ibrahim Özübüyük

16 Personaliteti i njeriut, detyrat dhe normat sociale / Xhemal Balla

18 Sahabët me radhë bëhen myslimanë me ftesën e të Dërguarit të Allahut (II)

20 Haxhi dhe roli i tij moral, edukativ e shpirtëror / Redaksia

22 Familja, themeli bazë i bashkësisë njerëzore / Aida Kurti

26 Të jetosh sunetin / Muhamed Asad



28 Puna, përpjekja dhe koha e tyre / Hasan Tahsini

32 Hafiz Ibrahim Repishti (1882-1943) / Personalitet

34 Femijët dhe namazi / Aisa Kokiçi

36 Gogësitja, një sinjal misterioz / Adem Arkanli

38 Rëndësia e motivimit / Redaksia



SINQERITETI, dhe gjurma e tij NË JETËN E BESIMTARIT

Allahu i Lartësuar ka shpallur në Kur'an: "E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër përveç se të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë." (98:5)

"Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve, Ai nuk ka ortak. Kjo më është urdhëruar dhe unë jam ndër të parët myslimanë." (6:162-163)

"Ai është që ka krijuar vdekjen dhe jetën, që t'ju provojë se kush nga ju do të bëjë vepra më të mira." (67:2)

Fudejl ibën Ajad duke komentuar këtë ajet ka thënë: "Mendohet për veprat më të sinqerta dhe më të drejta"- I thanë: "Çfarë do të thotë më të drejtat dhe më të sinqertat?"- Tha: "Nëse vepra është e sinqertë dhe nuk është e drejtë, nuk do të jetë e pranuar tek Allahu xh.sh. E njëjta gjë, nëse është e drejtë dhe nuk është e sinqertë, sërish nuk do të jetë e pranuar. Do të jetë e pranuar vetëm atëherë kur të jetë edhe e sinqertë edhe e drejtë. Vepra e sinqertë është ajo e cila është kryer për hir të Allahut xh.sh., dhe është e drejtë kur kjo vepër është kryer ashtu siç e ka kryer i Dërguari a.s."

Pastaj ka lexuar ajetin vijues:

"Kush shpreson në takimin me Zotin e vet, le të bëjë punë të mira dhe duke adhuruar Zotin të mos i përshkruajë Atij askënd të barabartë."(18:110)

Çfarë është sinqeriteti ?

Përkufizimet e sinqeritetit te dijetarët myslimanë janë në kuptime të përafërta dhe shumica e tyre sillen rreth asaj se sinqeriteti është gjendja kur njeriu me adhurimin (punën) e tij nuk synon asgjë tjetër përveç kënaqësisë dhe shpërblimit të Allahut xh.sh. Do të shtojmë disa nga këto përkufizime:

Iz ibën Abdus-Selam ka thënë: "Sinqeriteti është që njeriu të zbatojë ato çfarë i është urdhëruar, pastërtisht

për hir të Allahut xh.sh., dhe që me këtë të mos dëshirojë që njerëzit ta madhërojnë dhe nderojnë dhe as që të mos arrijë me të ndonjë përfitim në fe dhe as që me të të largojë nga vetja ndonjë fatkeqësi të kësaj bote."

Sehl ibën Abdullah ka thënë: "Sinqeriteti është që qëndrimi dhe lëvizja e njeriut të jenë vetëm për hir të Allahut xh.sh."

Fudejl ibën Ijad ka thënë: "Lënia e një vepre për hir të njerëzve është dukje (rija), ndërsa bërja e një vepre për hir të njerëzve është t'i përshkruash shok Allahut xh.sh. (shirk). Sinqeriteti është që Allahu të të ruajë dhe nga njëra dhe nga tjetra gjendje."

Vështirësia e sinqeritetit

Për të qenë të sinqertë në të gjitha veprat dhe fjalët, gjë për të cilën jemi të urdhëruar, është një nga vështirësitë me të cilat përballemi. Për këtë nuk mendohet vetëm për njerëzit mesatarë, të zakonshmit, por edhe për dijetarët dhe adhuruesit të cilët kanë treguar se është shumë e vështirë ta vësh në jetë dhe të ngjitesh deri tek shkalla e sinqeritetit, siç transmetohet nga muhadithi i madh, Sufjan eth-Theuri i cili ka thënë:

"Asgjë nuk ka qenë më e vështirë për mua sesa lufta me nijetin tim, i cili vazhdimisht ndryshon."

Për këtë i Dërguari i Allahut a.s. shpesh ka lexuar këtë lutje: "O Ti i Cili kthen zemrat, forcoje

zemrën time në fenë Tënde" (Tirmidhi: Da'vat; Ibën Maxhe: Efferat.) Gjithashtu tregohet se Profeti a.s. e kishte bërë zakon që të betohej kështu: "Jo, pasha Atë i Cili kthen zemrat." Zemrat janë të ndryshueshme në nijetet e tyre dhe në këmbënguljet e tyre. Ai i cili kërkon të bindet për këtë, le të mbikëqyrë zemrën e vet për një kohë jo më shumë se një orë, dhe do të kuptojë se tani dëshiron këtë, pastaj atë, tani është e përqendruar për hir të Allahut në namaz, pastaj befasisht ndryshon për

hir të një njeriu i cili po e shikon, në një çast me veprën e vet kërkon vetëm shpërblimin e Allahut dhe fill pas kësaj kërkon edhe shtesë nga kjo botë.

Sinqeriteti është i vështirë për atë se Allahu xh.sh. me urtësinë e Tij e ka bërë zemrën fushëbetejë ndërmjet shejtanit dhe engjëllit. Një çast e zotëron njëri, pastaj tjetri. Këtë më mirë na e ka sqaruar i Dërguari i Allahut a.s. kur ka thënë: "Në zemrën e birit të Ademit, dhe engjëlli dhe shejtani kanë pjesën (momentin) e vet. Gjatë kësaj kohe engjëlli e ngushëllon me mirësi dhe e frymëzon të besojë në atë çfarë Allahu xh.sh. i ka premtuar, ndërsa shejtani e frikëson me ligësi dhe e shtyn të kundërshtojë (të mos besojë) në atë çfarë Allahu xh.sh. ka premtuar." Dhe pas kësaj Pejgamberi a.s. ka lexuar ajetin: "Djali ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të këqija, ndërsa Allahu ju garanton falje (mekatesh) e begati; Allahu është dhurues i madh, është i ditur." (2:268) (Tirmidhiu)

Ibën Kajjim në veprën e tij "Igatherul Leuhani", duke vështruar mbi këtë hadith, është shprehur:

"Engjëlli dhe shejtani shkëmbehen në zemrën e njeriut ashtu siç shkëmbehen nata me ditën. Ka njerëz tek të cilët dita është më e gjatë se nata e tyre (kjo do të thotë se prania e engjëllit është më e gjatë nga prania e shejtanit), ndërsa tek të tjerë njerëz ndodh e kundërta. Ka nga ata tek të cilët vazhdimisht është ditë (do të thotë se gjatë gjithë kohës ka praninë e engjëjve), dhe ka të tjerë tek të cilët ndodh e kundërta".

Pengesat në rrugën e sinqeritetit

Dijetarët myslimanë përmendin tre gjëra të cilat mundet më shumë të prishin ose të pengojnë në rrugën e sinqeritetit dhe këto janë:

- që njeriut t'i duket vepra e tij si e madhe;
- që njeriu të kërkojë shpërblimin e kësaj bote për veprën e tij;
- që njeriu të jetë i kënaqur për atë që ka bërë.

Ajo që ndihmon prej pengesës së parë është kthimi nga të mirat me të cilat Allahut xh.sh. e ka furnizuar atë, kthimi, në udhëzimin e Allahut dhe në vetëdijen se vepra e kryer është prej Allahut dhe jo prej tij (personit) dhe që kjo nuk është asgjë tjetër përveçse vullneti i Allahut xh.sh. ashtu siç thotë i Lartësuar i librin e tij: "Ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron Allahu, Zoti i botëve."(81:29)

Çdo vepër e mirë e jona që kryejmë nuk duhet ta shikojmë ndryshe përveçse si lëvizja e pemëve dhe fërfërima e erës, që do të thotë se pemët dhe era nuk do të kishin pikënisje për lëvizje, nëse dikush tjetër do t'i detyronte, siç edhe ne, që jemi në thelb të vdekshëm, nuk do të mund të zgjoheshim dhe nuk do të lëviznim po të mos ishte mirësia e Allahut ndaj nesh dhe po të mos qe vullneti dhe dëshira e Tij.

Në veten e njeriut ka padije dhe krenari, e prej natyre vetvetja (nefsi) është e ngathët dhe i jep përparësi

pasioneve dhe gjërave të pavlerë. Burim i kësaj është edhe përvjedhja prej vështirësive. Si e tillë është e sigurt se nuk do të kishte mundësi të tregonte asnjë të mirë nëse nuk do të qe udhëzimi i Allahut xh.sh. për të.

Na mjafton si argument për të gjithë këtë që kemi thënë ajo që Allahu xh.sh. na thotë për robin e Tij më të zgjedhur Muhamedin a.s.: "Dhe sikur Ne të mos të kishim forcuar ty, ti gati anove diçka pak tek ta".

Ajo e cila ndihmon në kapërcimin e pengesës së tretë (dhe kjo është të qenit i kënaqur me veprën tënde) janë dy gjëra:

a- të kthyerit dhe të vështruarit në mangësitë apo tepritë e dëmshme në atë vepër, si edhe njohja e pamundësisë për ta mbajtur veprën larg ndikimit të shejtanit dhe dobësive të vetes.

Është pyetur Pejgamberi a.s. për shpërqendrimin e vështrimit të atij që fal namaz, e është përgjigjur: "Kjo është ajo pjesë të cilën shejtani arrin t'ia grabisë nga namazi." (Buhari).

Kur vetëm një vështrim i paqëllimtë i njeriut gjatë namazit, bie në atë pjesë që shejtani ia grabiti nga namazi, çfarë do të bëhej atëherë në kthimin e plotë të zemrës drejt dikujt tjetër përveç Allahut xh.sh.?

b- dija për atë çka Allahu xh.sh. urdhëron, në mënyrë që të jetë vërtetë i adhurar; dija që njeriu është i dobët dhe i pamundur dhe larg përmbushjes së detyrës ndaj Allahut xh.sh. e pikërisht për këtë nuk guxon të jetë i kënaqur me veprën e vet dhe të druhet që të dalë përpara Allahut me atë vepër.

Disa thënie për sinqeritetin

Profeti Jakub a.s. ka thënë: "I sinqertë është ai njeri, i cili fsheh veprat e veta të mira në të njëjtën mënyrë siç fsheh veprat e këqija".

Profeti Ejub a.s. ka thënë: "Bërja e nijetit, për njerëzit e sinqertë, është më e vështirë se çdo vepër tjetër".


Përcaktimet për veprat që kryhen pa sinqeritet

Transmetohet nga një numër i madh dijetarësh myslimanë, që sinqeritetin e numërojnë si pjesë të pandashme të adhurimit, se adhurimi i kryer pa sinqeritet nuk është i vërtetë. Ashtu siç transmetohet nga Izn Abdus-Selam që ka thënë: "Sinqeriteti është kusht për adhurimin e vërtetë" (Kavaidul-Ahkam), ndërsa nga Kurtubiu transmetohet se ka thënë se sinqeriteti në adhurim është detyrë. (Tefsirul-Kurtubi)

Një qëndrim i tillë mbështetet në fjalët e Pejgamberit a.s.: "Allahu pranon vetëm ato vepra, të cilat janë të sinqerta, të kryera vetëm për hir të Tij dhe me të cilat kërkohet vetëm kënaqësia e Tij". (Nesai dhe Ebu Umame)

Lusim Allahun të na bëjë të sinqertë në fjalët tona, në veprat tona dhe të na pastrojë nga gjithçka që shemb sinqeritetin.

Kuptimi dhe vlerat e Haxhit



Rituali i haxhit, në formën e tij të njohur, është një adhurim që zë fill nga koha e Ibrahimit a.s.. Kur’ani fisnik, në ajetet 26-28 të sures Haxh, bën fjalë për haxhin e Ibrahimit, për thirrjen e tij drejtuar njerëzve për të marrë pjesë në haxh, për historinë e Qabes e të riteve të haxhit. Haxhi është vizita që kryhet në Qabe dhe në vendet e bekuara përreth saj, me qëllim përmbushjen e një adhurimi fetar në intervalin e caktuar kohor. Në Kur’an është urdhëruar: “Kryeni Haxhin dhe Umren për

hir të Allahut...” (Bekare, 196). Riteve që kryhen në haxh, me një shprehje të përgjithshme, u thuhet “menasik”, ndërsa ai që e zbaton këtë ritual quhet “haxhi”.

Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, në një hadith ka urdhëruar: “Pa dyshim, Allahu jua ka bërë detyrim haxhin, ndaj kryejeni atë” (Muslim, Haxh 412; Nesai, Menasik,1). Ndërsa një tjetër hadith është formuluar kështu: “Islami ngrihet mbi pesë shtylla. Këto janë: të dëshmosh se nuk ka tjetër Zot përveç Allahut dhe se

Muhamedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të mbash agjërimin, të japësh zekatin dhe të kryesh haxhin." Kështu, Profeti a.s. e ka cilësuar haxhin si një ndër pesë kushtet themelore të Islamit dhe ka treguar personalisht në mënyrë praktike se si duhet bërë ai.

Kur Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, u bëri të ditur shokëve të tij obligimin e haxhit, njëri prej tyre pyeti: "Çdo vit?" Profeti heshti. Kur kjo pyetje u përsërit tri herë, ai u përgjigj: "Nëse do të thosha po, haxhi do t'ju bëhej i detyruar për çdo vit dhe ju nuk do të kishit mundësi për këtë" (Muslim, Haxh, 412; Nesai, Menasik, 1). Çdo mysliman, mashkull apo femër, që plotëson kushtet përkatëse, pra që ka mundësitë shëndetësore dhe financiare për të kryer haxhin, të paktën një herë në jetën e tij, duhet ta çojë në vend këtë detyrim. Rituali i haxhit, sapo të krijohet mundësitë, duhet të përmbushet pa vonesë. Kryerja e haxhit pa u vonuar, krahas ajeteve përkatëse që shërbejnë si argument, theksohet edhe prej hadithit vijues:

"Nxitoni të shkoni në haxh, sepse askush prej jush nuk mund ta dijë se kur do t'i vijë vdekja" (Ebu Davud, Menasik,5; Ibn Maxhe, Menasik, 1).

Haxhi ka plot dobi individuale dhe shoqërore. Më kryesoret janë: haxhi mundëson që individit t'i falen mëkatet dhe zemra e tij të pastrohet prej gjynaheve. Profeti i nderuar, paqja qoftë mbi të, në një hadith të tij thotë: "Kushdo që për hir të Allahut kryen haxhin dhe u shmangët fjalëve dhe sjelljeve të pahijshme e nuk përlyhet prej mëkatesh, kthehet i pastruar prej mëkateve sikur sapo të ketë lindur nga nëna" (Buhari; Haxh, 4). Në të tjera thënie të tij qëndron: "Shpërbliimi i haxhit të pranuar nuk është asgjë tjetër veç parajsës"; "Edhe në umre pastrohen mëkatet e kryera në kohën që ndan njërën umre nga tjetra" (Muslim, Haxh, 437; Nesai, Menasik, 3-5).

Pyetjes "Cila nga veprat është më e rëndësishmja?", Profeti ynë i është përgjigjur: "Besimi tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij". I pyetur: "Po më pas?", është përgjigjur: "Xhihadi në rrugën e Allahut". I pyetur sërish: "Po më pas?", ka urdhëruar e ka thënë: "Haxhi i pranuar." (Buhari, Haxh, 4; Nesai, Menasik, 4).

Vlerat e besimtarëve që kryejnë haxhin, në vështrimin e Allahut janë shumë të larta. Profeti ynë i nderuar e ka shprehur këtë të vërtetë duke pohuar: "Ata që kryejnë haxhin dhe umren janë mysafirët e Allahut. Nëse i drejtohen Allahut me lutje, Ai ua pranon. Në iu drejtojnë me pendesë, Ai i fal." (Ibni Maxhe, Menasik, 5). Në një tjetër hadith, që thotë: "Kryejini njërën pas tjetrës haxhin dhe umren, sepse haxhi dhe umra i asgjësojnë varfërinë (për shkak të tregtisë që mund të bëhet) dhe gjynahet siç pastron kaceku hekurin, arin dhe argjendin prej ndryshkut" (Tirmidhi; Haxh, 2; Nesai, Menasik, 6), na jepet sihariqi se haxhi, krahas pastrimit prej mëkateve, bëhet shkak që njeriu të shpëtojë edhe prej varfërisë.

Haxhi dhe umra bëhen shkak që faltorja e bekuar e

Qabes çdo vit të mbushet me shend e gjallëri. Haxhi e pastron egon e njeriut prej mëkateve, e bën atë të dëlirë, e pajis me kthjelltësi besimi, i çel dyert e një jete të re, përforcon jetën shpirtërore, konsolidon besimin që ai ndien kundrejt mëshirës dhe faljes hyjnore. Haxhi forcon e rrit besimin, ndihmon në ripërtëritjen e besës së dhënë Allahut, çon drejt asaj pendese të fuqishme që nuk shkelet lehtë, e pastron krejt shpirtin duke rafinuar ndjenjat dhe thujtë të jep krahë atij.

Haxhi i kujton njeriut të kaluarën e shkëlqyer të Islamit. Ai i sjell ndërmend besimtarit Profetin tonë, paqja qoftë mbi të, që me moralin dhe me veprat e tij ndriçoi botën, si dhe sakrificat dhe heroizmat e sahabëve të tij të zgjedhur dhe të njerëzve të ruajtur që i pasuan ata në mënyrën më të bukur.

Për më tepër, haxhi e mëson njeriun me durim, me vetëdisiplinë dhe bëhet shkak që ai të fitojë ndërgjegjen e bindjes ndaj urdhëresave hyjnore. Përmes ritualit të haxhit, njeriu e falënderon më mirë Zotin e vet, gjen rrugën e të qenët më thellësisht mirënjohës për mirësitë e pasurisë, të shëndetit e të mirëqenies që Zoti i ka dhuruar.

Për sa u përket vlerave shoqërore, haxhi, pa marrë parasysh ndarje në baza ngjyre, gjuhe, race, kombësie, kulture, pozite shoqërore a posti politik, bashkon në një qëllim të vetëm miliona myslimanë, duke u bërë shkak për krijimin e një tabloje fort të gjallë të barazisë e të vëllazërisë. Të gjithë haxhinjtë, të pasur e të varfër, të fuqishëm e të dobët, të veshur njëlloj, duke ndjekur të njëjtat rregulla, duke iu nënshtruar të njëjtave vështirësi, duke lëvizur në të njëjtat kushte, kalojnë nëpër një edukim të barazisë fizike e të vëllazërisë, teksa një besimtar i pasur që ka në zotërim pasuri të mëdha, sikurse dhe një besimtar më i varfër e që përjeton shumë vështirësi ekonomike, ngrejnë së bashku duart për t'u lutur në Arafat dhe ecin pranë e pranë në tavaf rrotull Qabes. Rituali i haxhit u mëson njerëzve që të mos mburren me pozitën shoqërore e politike, me begatinë e me pasurinë, por të njihen e të shoqërohen me myslimanë të tjerë.

Ritualit i haxhit lë të myslimanët kujtime të thella që nuk fshihen dot gjatë gjithë jetës. Në sajë të haxhit, mes myslimanëve që vijnë e bashkohen nga vende të ndryshme të botës lindin njohje e ndërveprime të bukura. Myslimani që kryen haxhin zhvillon cilësi të bukura si durimi, kapërcimi i vështirësive, të mbështeturit dhe të ndihmuarit e ndërsjellë dhe përshtatja me rregulla të caktuara.

Haxhi i mbart vizitorët në kohë katërmbëdhjetë shekuj më parë. Ai u kujton atyre ato beteja të mëdha që janë zhvilluar në ato vende në emër të besimit. Haxhi e bën njeriun të përjetojë një panoramë që i përket parajsës dhe i shfaq të vërtetën se në këtë botë ai s'është veçse një vizitor i përkohshëm.



1

NJË DELEGACION I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË VIZITON SELINË E KOMUNITETIT MUSLIMAN SHQIPTAR NË ZVICËR

Delegacioni i kryesuar nga kryetari, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një vizitë dy ditore në Zvicër me rastin e Muajit të Ramazanit, ku u pritën nga kryetari, z. Mehas ef. Alija dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, ndër ta kryetari i xhamisë së njohur El-Hidaje në Zvicër, z. Sadush Ajrullai.

Krytari i KMSHZ, z. Alija pasi i uroi mirëseardhjen delegacionit shqiptar, i njohu ata me institucionin që ai drejton, strukturën dhe veprimtarinë fetare e kulturore.

Nga ana e tij, z. Spahiu, i shprehu atyre falenderime të përzemërta për pritjen. Ai theksoi se e ka pritur me emocion takimin me shqiptarët e diasporës të cilët janë shembull i shkëlqyer i përfaqësimit të islamit dhe shqiptarizmit në çdo vend të Europës ku ata jetojnë e punojnë.

Në fund të vizitës zyrtare, z. Spahiu u dha nga një medaljon, i cili simbolizon 100-vjetorin e themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Duke qenë se ishte ditë e Xhuma, kryetari Spahiu mbajti edhe hutben e ditës në xhaminë El-Hidaje.

2

KMSH VIZITON QENDRAT E TJERA ISLAME NË ZVICËR

Gjatë qëndrimit në Zvicër, delegacioni i KMSH ka vijuar vizitat në qendra tjera islame, siç ishte xhamia e Flumsit.

Kryetari Spahiu dhe delegacioni shoqërues u pritën nga kryetari i xhamisë, z. Mensur ef. Nuhiu, ish-kryetari, z. Adnan ef. Fazliu dhe imami, z. Veton ef. Tulla.

Biseda fetare e sociale rreth muajit të begatë të Ramazanit dhe aktiviteteve në këtë muaj ishin tematika kryesore e bashkëbisedimit me xhematin.

Në fund të vizitës në Zvicër, delegacioni i Komunitetit Mysliman zhvilloi dy vizita të ndryshme me; kryesinë e xhamisë së Zyrihut dhe atë të xhamisë së Wetzikonit.

Kryetari u prit nga kryesia e xhamisë së Zyrihut me kryetar Ismail ef. Ademi dhe imam Nebi Rexhepi, nënkryetari u prit nga kryetari i xhamisë së Wetzikonit Arianit ef. Zhuta dhe imami Valter ef. Samurri.





3

ZHVILLOHET KONFERENCA ME TEMË “KURANI DHE INTERPRETIMI I TIJ NË SHOQËRITË MODERNE”

Myftinia e Elbasanit, me datë 15.04.2023 organizoi konferencën me temë “Kurani dhe Interpretimi i tij në Shoqëritë Moderne”. Në këtë konferencë mori pjesë kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, myftinj, studiues, hoxhallarë dhe personalitete të njohur.

Në fjalën e hapjes kryetari Spahiu foli për rolin e interpretimit të Kuranit në shoqërinë moderne. Ai shprehu qëndrimin e tij se Kuranit duhet t'i jepet një interpretim i përshtatshëm me kohën dhe rrethanat aktuale, në mënyrë që mesazhet e tij të shkojnë te çdo njeri.

“Për çdo kohë e shoqëri interpretimi, zbërthimi dhe kontekstualizimi i Kuranit bëhet nga dijetarë e studiues.

Unë vetë vij nga kjo shkollë, interpretimi i Kuranit, dhe e di shumë mirë këtë aspekt sa i rëndësishëm që është për çdo besimtar dhe jo vetëm.

Njohja e gjuhëve, të qenit në kontakt të vazhdueshëm me dijetarët dhe interpretuesit më të mirë të Kuranit në ditët e sotme, edhe ne, hoxhallarët, por edhe studiuesit shqiptar kanë mundësi të përqasin interpretimet më të mira e më të drejta të Kuranit edhe në vendin tonë.

Moderniteti ka diversifikuar shumë komunikimin publik. Interneti, rrjetet sociale, pra, shumëllojshmëria e kanaleve të komunikimit për të përcuar qartë dhe pastër mesazhin e Kuranit në sa më shumë njerëz është një favor i kohës sonë.” - u shpreh kryetari Spahiu ndër të tjera.

Më tej konferenca vijoi me fjalën e Myftiut të Elbasanit, z. Agim Duka dhe referimet e të ftuarve të tjerë.





4

CEREMONIA E PRITJES ME RASTIN E 100-VJETORIT TË THEMELIT TË KOMUNITETIT MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Me rastin e 100-vjetorit të themelimit të institucionit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, zhvilloi pritjen e rastit në ambientet e "Tirana International Hotel".

Në këtë reception, morën pjesë: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, krerët e komuniteteve të tjera fetare të vendit tonë, përfaqësuesit e trupës diplomatike me seli në Tiranë, Kryetarët e Bashkësive Fetare Islame të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe ata të Diasporës, myftij dhe imamë të shumtë të KMSH-së, drejtues të lartë institucionesh publike e private, intelektualë, akademikë, historianë, si dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm të institucionit ndër vite.

Kjo mbrëmje nisi me leximin e disa ajeteve të Kuranit Famëlartë nga imami i xhamisë "Et'hem Bej", njëkohësisht edhe moderatori i programit, z. Elton Karaj.

Për të vijuar më pas me himnin kombëtar dhe fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u shpreh krenar për 100 vitet histori të institucionit dhe entuziast për atë ç'ka premtan e ardhmja në përhapjen me dinjitet të mesazhit të paqte të fesë Islame në vendin tonë.

Kjo mbrëmje jubilarë në historinë e institucionit vijoi më tej me fjalën përshëndetëse të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, i cili bëri një rezymë të shkurtër të kontributit të klerit mysliman në etapat më të rëndësishme të historisë së kombit tonë.

Një tjetër moment i veçantë i kësaj mbrëmjeje, që zuri vend fill pas fjalëve përshëndetëse, ishte edhe prerja e tortes, simbolikë e këtij 100-vjetori, nga Kryetari i Komunitetit Mysliman dhe Presidenti i Republikës.

Më tej, kjo mbrëmje vijoi në formën e diskutimeve të lira ndërmjet të pranishmëve.





SI DUHET TË JETË METODA E KUMTIMIT NDAJ NJË TË RIU? (I)



Siç e kemi thënë më parë, çdo musliman, pavarësisht nga mosha dhe niveli, duhet të shpjegojë çështjet që duhen thënë rreth tij. Kjo është detyra e tij më jetike. Urtësia e dërgimit të peygambereve është përmbushja e kësaj detyre. Këtu, ne gjendemi përballë një detyrë kaq të shenjtë. Në këtë aspekt, shërbimi (hizmeti) ndaj fesë është një garë virtuti. Dhe ata që shërbejnë në këtë fushë janë njerëzit më të virtytshëm në botë.

Sot mendimet dhe idetë janë larguar shumë nga Islami. Është sikur Islami të jetë shtyrë nga jeta. Shkenca dhe teknologjia gjithmonë janë treguar armiqësore ndaj fesë dhe masat janë mashtruar. Prandaj, është e nevojshme të njihen shumë mirë çështjet e Islamit, të Kur'anit dhe të besimit, dhe më pas t'ua shpjegojmë ngadalë të tjerëve këto kuptime ndriçuese, delikate dhe pa u imponuar.

Çdo punë ka teknikën e vet. Pa këtë recetë dhe këtë teknikë nuk mund të flitet për një degë të shkencës apo një punë të caktuar. Kur është kështu, gjërat më të shenjta dhe më të vlefshme, si detyra e kumtimit dhe udhëzimit, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja dhe thirrja në fe duhet të kenë disa metoda (usul) dhe teknika të tyre.

Për të kryer detyrën e udhëzimit dhe kumtimit siç duhet, disa çështje duhet të merren parasysh. Le të përpiqemi t'i përmbledhim ato:

1. Çështjet fetare duhet të dihen mirë

Para së gjithash, një person i predikimit duhet të edukojë veten tërësisht përpara se t'u tregojë të tjerëve për fenë që i përket dhe faktet që përmban ajo fe. Përndryshe, ai mund të bëjë shumë gabime për hir të fesë dhe mund t'i frikësojë të tjerët, dhe kështu njerëzit fillojnë të qendrojnë larg tij dhe fesë. Para së gjithash, ai duhet të dijë shumë mirë Librin e Allahut, Kur'anin. Ai duhet të përpiqet të kuptojë domethënien dhe frymën e Kur'anit së bashku me formulimin e tij dhe të përdorë përkthimet dhe tefsiret në këtë drejtim. Përveç kësaj, duhet të dihet jeta e Pejgamberit tonë të dashur (salallahu alejhi ue selem), hadithet, sahabët dhe historia e Islamit në terma të përgjithshëm. Më pas, ai duhet të lexojë librat ku mund të mësojë njohuritë themelore dhe të vërtetat që do të thotë.

Në lidhje me njohjen e fesë, ne kemi dy burime: Kur'anin dhe Sunnetin. Kur shpjegohet diçka në emër të Islamit, ajo duhet të shpjegohet brenda parimeve të këtyre dy burimeve kryesore dhe me një njohuri të saktë dhe thellë të temës. Ato që do të tregojmë duhet të jenë gjëra që ne i kuptojmë dhe t'i përpunojmë në mënyrë që bashkëbiseduesit ynë t'i kuptojnë lehtësisht ato.

Sipas fjalëve të Bediuzamanit, ne duhet të jemi si delet, nuk duhet të sillemi si zogjtë dhe t'u bëjmë atyre të vjella. Ne duhet ta tretim atë që kemi mësuar dhe ta kthejmë në qumësht dhe t'ua paraqesim zemrave nevojtare, si qumështi, si një burim shërimi. Si i tillë, kur kjo dituri të

hyjë në shpirtin e tyre, ajo menjëherë do të bashkohet dhe do të bëhet mjaltë në emër të dijes dhe urtësisë.

Sigurisht, kjo do të arrihet duke zgjeruar rrethin e leximit, të kuptuarit, kulturës dhe njohurive. Ata që e pranojnë atë si detyrë udhëzimi duhet patjetër t'i kushtojnë një pjesë të caktuar të kohës leximit. Një person i privuar nga kultura e kohës në të cilën jeton nuk ka asgjë për t'i thënë bashkëbiseduesit. Ose me fjalë të tjera, një person me një nivel të cekët të kulturës nuk mund të kënaqë personin me të cilin është i zënë për një kohë të gjatë. Prandaj, udhërrëfyesi/murshidi, i cili duhet të merret me njerëz në të gjitha nivelet, duhet të zotërojë temën për të cilën flet të paktën në atë masë sa të kënaqë bashkëbiseduesin e tij.

Pra, ata që e bëjnë udhëzimin synimin e jetës së tyre, duhet të pajisen me dituri dhe urtësi. Ajo që do të thotë një person pa njohuri nuk është asgjë më shumë se padituri. Përkundrazi, janë njerëz të tillë që përpiqen të mbulojnë boshllëqet e tyre në çështjet për të cilat do të flasin me imponim dhe zemërim. Në këtë rast, bashkëbiseduesit e tyre nuk duan të pranojnë as çështjen më të arsyeshme dhe më të lehtë, duke qenë kështu si reagim ndaj veprimeve të tyre.

2. Duhet njohur shkencën dhe teknologjinë aktuale

Në epokën tonë, botëkuptimi, vlerësimi i gjërave dhe ngjarjeve ka ndryshuar krejtësisht. Sot mbizotëron logjika dhe racionalizmi. Masat që kanë nevojë për besim flasin nën emrin e shkencës dhe filozofisë. Kundër kësaj, muslimani duhet të përgjigjet me të njëjtën teknikë. Kjo lidhet ngushtë me njohjen e kulturës së kohës së tij. Në një farë mënyre, kjo është dituri dhe mençuri e vërtetë. Përveç kësaj, dituria dhe urtësia janë cilësi të pandashme të një besimtari.

Edhe nëse udhërrëfyesit e sotëm janë enciklopedikë, ata duhet të ndjekin shkencën dhe teknikën e shekullit tonë. Përndryshe, udhëzimi i tyre pushon së qeni një udhëzim i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, dhe bëhet thjeshtë një muhabet i rëndomtë.

Një person që nuk e njeh kohën e tij do të thotë se ai jeton në një korridor të errët. Nëse një person i tillë përpiqet t'u shpjegojë diçka njerëzve të tjerë në emër të fesë dhe besimit, fuqia e tij e ndikimit zvogëlohet. Në fakt, rrotat e kohës dhe ngjarjeve do ta bëjnë atë plotësisht të dobët dhe të paefektshëm nesër, nëse jo sot. Për këtë arsye, muslimani duhet t'i shpjegojë çështjet në përputhje me nivelin shkencor dhe kulturor të shekullit në të cilin jeton dhe në një paralele ekuivalente.

3. Duhet të kërkohen mënyra për të hyrë në shpirtin e bashkëbiseduesit dhe për të fituar zemrën e tij.

Para së gjithash duhet të hetohen mënyrat e hyrjes në shpirtin e njeriut. Kjo është një qasje njerëzore. Është e nevojshme të zbatojmë në praktikë atë që na është

urdhëruar në frymën e fesë, si dhurimi i ndonjë dhurate apo zgjidhja e një problemi që lidhet me të.

Për të hyrë në zemrat e bashkëbiseduesve tanë, duhet provuar çdo rrugë legjitime dhe personit të cilit do t'i tregojmë diçka, fillimisht duhet të pranojë miqësinë tonë personale. Ky është një faktor i rëndësishëm në pranimin e ideve që do t'i japim dhe nuk duhet neglizhuar.

4. Gjatë shpjegimit të çështjeve duhet të merret parasysh niveli i bashkëbiseduesit

Shpjegimi i çështjeve duke zbritur në nivelin e bashkëbiseduesit është një moral hyjnor. Pejgamberi ynë na fton të moralizojmë me moralin e Allahut. Kur'ani është një fjalë hyjnore që ka zbritur në nivelin e mendjes njerëzore nga fillimi deri në fund.

Të rinjtë e sotëm nuk janë të njohur me termat dhe shprehjet fetare. Ju duhet të flisni me ta në një gjuhë që ata ende mund ta kuptojnë. Ashtu siç ndjekim ecjen e një fëmije tre vjeçar që e nxjerrim për dore, flasim si ai, qeshim si ai dhe sillemi si ai; Po kështu, është e domosdoshme që mirëkuptimi i bashkëbiseduesve të merret parasysh gjatë udhëzimit dhe kumtimit.

5. Të shmangen debatet e panevojshme

Në bisedat dypalëshe duhet pasur shumë kujdes që të mos e çoni çështjen në mosmarrëveshje. Sepse, nëpër debate janë egoja dhe vetja që flasin dhe jo e drejta. Për këtë arsye, sado bindëse të jetë ajo për të cilën kemi biseduar dhe do të flasim, nuk do të ndikojë tek bashkëbiseduesi ynë.

Kur ta shikojmë çështjen nga pikëpamja psikologjike, do të zbulohet se sa i papërshtatshëm dhe joadekuat është debati për zbulimin e së vërtetës dhe të realitetit. Ashtu siç përgatiteshim me ide dhe mendime për të mposhtur armikun tonë ndërsa përgatiteshim për një diskutim, bashkëbiseduesi ynë është të paktën po aq i përgatitur sa ne. Provat që do t'i sjellim, ai sigurisht që do t'i përgjigjet me një kundërprovë dhe biseda do të hyjë në një rreth vicioz sa nuk do të arrihet asnjë rezultat edhe nëse flitet me ditë të tëra.

6. Duhet të fitohet besimi i bashkëbiseduesit tonë

Bashkëbiseduesi juaj duhet t'ju besojë dhe të jetë aq i lidhur me ju, saqë nëse ju krahason me të gjithë njerëzit më të dashur, duhet t'ju vlersojë më shumë nga të gjithë. Sepse marrëdhënia juaj me të është vetëm për Allahun. Për shkak se ju e doni atë për hir të Allahut, kjo dashuri do të tregojë efektin e saj në zemrën e tij. Kjo epërsi duhet të jetë aq e madhe sa duhet të jetë në gjendje të preferojë përgjegjësitë e rënda të të qenit me ju në vend të kënaqësisë dhe qefit së palës tjetër. Në fakt, të gjitha llojet e reziqeve dhe të gjitha llojet e vuajtjeve

që janë të destinuara të durohen për hir të idealit për të cilin synoni, duhet të jenë më të këndshme për të sesa rehatia dhe vetëkënaqësia e jetës së mëparshme. Kjo do të jetë e mundur vetëm nëse ai person ju njeht mirë dhe ju beson pa masë.

7. Tregohuni i arsyeshem dhe realist

Një njeri i kumtimit është një njeri i logjikës dhe realitetit. Duke vlerësuar ngjarjet dhe duke i treguar diçka bashkëbiseduesit, ai duhet të përpiqet gjithmonë ta bindë duke i treguar çështjet në një kornizë logjike sipas nivelit të personit tjetër. Në masën e logjikës së tij, njerëzit e kumtimit nuk janë të çuditshëm në shoqëri dhe ajo që ata thonë pranohet në të njëjtën masë. Ja një shembull i mrekullueshëm nga i Dërguari i Allahut:

Xhulejbib (r.a.) ishte një i ri që kishte fiksuar ndaj grave. Një ditë, Xhulejbibi shkoi në prani të të Dërguarit të Allahut (s.a.) dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Më lejo të bëj zina!"

Për shkak të një shprehjeje të tillë, sahabët i thoshin atij: "Hesht! Hesht!" ata përpiqen ta heshtin atë.

Por Pejgamberi i tha "Afrohu këtu". Xhulejbibi erdhi dhe u ul pranë Profetit. Profeti filloi të fliste me të:

"Me trego. A do të pranonoje që dikush tjetër të kryejë zina me nënën tënde?"

"T'u bëfsha kurban, jo, nuk do të pranoja".

"Askush nuk do të pranonte që dikush të bënte zina me nënën e tij.

Dhe a do të pranoje që dikush të bënte zina me vajzën tënde?"

"Jo nuk do të pranoja".

"Atëherë askush nuk dëshiron të kryejë zina me vajzën e tij. Dëshiron që dikush tjetër të kryejë zina me motrën tënde?"

"Jo, nuk do të pranoja asesi".

"Askush nuk dëshiron të kryejë zina me motrën e tij.

Pa më thuaj, a do të të pëlqente që dikush të bënte zina me hallën tënde?"

"Jo, absolutisht jo."

"Epo askujt s'i pëlqen me hallen e dikujt të bënte zina."

Dhe a do të pranoje që dikush të kryejë zina me tezen tënde?"

"Jo, nuk do të kënaqem as me këtë."

"Askush nuk do të pranonte të kryente zina me tezen e tij."

Pra, me këtë fjalim, i Dërguari i Allahut e bindi mendjen e Xhulejbibit në logjikën e arsyes dhe e bindi atë. Pastaj vendosi dorën në gjoksin e këtij të riu dhe lutet:

"O Zot! Fale mëkatën e tij, pastroje zemrën e tij dhe ruaje nderin e tij."¹

Pas kësaj lutjeje, Xhulejbibi u bë një shembull i dëlirësisë.

Përktheu: Haki Sahitaj

1 Ahmed b. Hanbel, Musned, 4/420, 421; Hejthemî, Mexh-meu'z-zevâid, 9/368.



PERSONALITETI I NJERIUT

Detyrat dhe normat sociale



Roli i njeriut zë një vend të rëndësishëm në jetën shoqërore, pasi ai kryen detyra e funksione të caktuara, lidhur me të drejtat, detyrat e normat sociale.

Në jetën e përditshme, me personalitetin konceptohet njeriu që kryen funksione e detyra të rëndësishme shoqërore, fetare e shtetërore.

Në fenë islame personaliteti trajtohet si njeri konkret, i vetëdijshëm e normal, të cilin Zoti xh.sh. e krijoi në mënyrë të përsosur e tha: "Ne me të vërtetë i kemi nderuar bijtë e Ademit". Pra, njeriu trajtohet si qenie që jeton në shoqëri, që ka vetëdije dhe punon aktivisht për zhvillimin e saj. Në Islam mendja, vetëdija është themeli i besimit (Imanit). Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, ka thënë: "Mendjes, kur e krijoi Zoti i tha: "Më të dashur se ty pranë meje, nuk kam krijuar tjetër send". Dhe përsëri i dërguari i Allahut thotë: "Shpëtoi kush u pajis me mendje". Nga kjo kuptohet se njeriu si qenie shoqërore e pajisur me mendje, karakterizohet për formimin e personalitetin si tërësi marrëdhëniesh shoqërore e dukurish psikike të shprehura në jetën praktike. Ai është në kontakt të vazhdueshëm me ato që e rrethojnë. Por që këto marrëdhënie të jenë të sqarta, duhet prej njeriut kërkohet të njohë vetveten e pastaj të fillojë me procesin e njohjes me të tjerët. Për këtë profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Kush njeh vetveten, njeh Zotin". Një njohje e vetëdijshme, me mendje e zemër, që i bën vetëkontroll veprimtarisë të tij, i jep kuptim vetes si njeri, me tërësinë e cilësive morale, të mendimit dhe të gjykimit. Atëherë shpirti i njeriut i drejtohet krijuesit të tij, e falënderon për gjithçka i ka dhuruar me falje e përkushtim. Në këtë mënyrë unifikohet trupi me shpirtin, përmbajtja me formën, lënda me idenë, mishi e fryma e identitetit të tij si njeri besimtar. Duke qenë i tillë, roli dhe vlera e tij në jetën familjare e shoqërore ka karakter human sepse buron nga shpirti i pastër njerëzor.

Ne si shoqëri trashëgojmë vlera morale pozitive si mbrojtja e nderit, mbrojtja e fjalës së dhënë, të qenët bujar e mikpritës, ndihma ndaj nevojtarëve etj. Feja islame, që i ka këto vlera në parimet e saj, i ka pasuruar e çuar më tej, duke e konsideruar moralin si hyjnor, për të cilin profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Jam dërguar për të përsosur moralin njerëzor". Islami e ka detyrë të ditës që këtë moral ta shtrijë në të gjithë shoqërinë, e ta ruajë të pastër nga ndikimet e jashtme, që tentojnë të futen në emër të së resë apo modernes. Besimtarët myslimanë duhet t'i qëndrojnë vetëdijes islame, e nuk duhet ta humbin atë për asnjë çast, me qëllim që të ruhet e pastër struktura morale e shoqërisë sonë, që e trashëgojmë që në lashtësi. Por gjatë tranzicionit që po kalon shoqëria jonë, krahas vlerave të mëdha që na solli demokracia, kanë ngritur krye disa fenomene negative si: dhuna në familje, krimi, droga, prostitucioni, vjedhja, tradhtia etj., që dëmtojnë shumë karakterin shoqëror dhe bëhen pengesë serioze për të ndërtuar një shoqëri demokratike.

Promovimi i vlerave pozitive është problem dite jo vetëm për besimtarët, por për të gjithë institucionet arsimore e kulturore, si dhe i organizatave joqeveritare. Këto vlera janë faktor i rëndësishëm në zhvillimin e jetës shpirtërore të shoqërisë, por, njëkohësisht, janë mjete të rëndësishme në ristrukturimin e saj ekonomik, arsimor e kulturor.

Njohja e udhëzimit hyjnor, të Kur'anit Famëlartë si kod jetik, do të përbente kushtin bazë në ndërtimin e një edukate të shëndoshë tek secili besimtar. Veçanërisht edukimi i rinisë, djem-vajza me besimin te Zoti, do t'i bënte të vetëdijshëm për pajisjen me vlera etiko-morale, si bazë e formimit dhe funksionimit të personalitetit të tyre në familje e shoqëri. Por, pa lënë mënjanë dhe prindërit e tyre, me synimin që të ripërtërihen vlerat e besimit, të dhunuar për një kohë të gjatë nga regjimi komunist. Duhet që edhe këta të bëhen të vetëdijshëm për rolin e vlerave etiko-morale në jetën qytetare, të frymëzuar nga ideja e lartë e besimit te Zoti. Pa këtë ripërtëritje, pa këtë vetëdijesim të besimtarëve nuk bëhet fjalë për t'i bërë tonat ato vlera të shëndosha, që të bëhen pengesë për depërtimin e antivlerave.

Prandaj çdo njeri, në veçanti besimtar i me vetëdije të plotë, duhet të ndiejë përgjegjësi si individ, por edhe ndaj familjes e shoqërisë, për ruajtjen e promovimin e vlerave morale. Ky është atributi hyjnor, i mbrujtur në shpirtin e njeriut dhe që e ushqen dhe e brumos personalitetin e tij. Ky i jep dritë materies, trupit si faktor që përcakton dimensionet e personalitetit të njeriut.

Duke njohur tiparet morale të vetvetes e të shoqërisë që të rrethon, forcohet dashuria e harmonia në mes njëri-tjetrit ashtu siç thotë Zoti në Kur'an: "Besimtarët janë vëllezër". Ndërsa profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Duaj për tjetrin atë çka do për veten tënde". Pra, forcohet te secili ndjenja e lindur e dashurisë për njëri-tjetrin e deri për të sakrifikuar për të. Atëherë me vetëdije i bëhen pengesë shfaqjes së veseve negative si: egoizmi i tepruar, individualizmi, rryshfeti, korrupsioni etj.

Intelektualëve e teologëve u takon barra kryesore, që me ndërgjegje të lartë, për ruajtjen e vlerave etiko-morale në shoqëri, të qëndrojnë në ballë të propagandës informuese e sqaruese për dëmin e antivlerave dhe rrezikun që ato i shkaktojnë individit, familjes e shoqërisë. Atyre u takon të parëve që t'u bëhen barrikadë veseve negative, që po ngrenë krye në shoqërinë tonë. Përdorimi i medias së shkruar e vizive nga ata, ka rol të rëndësishëm në sensibilizimin e të gjithë shoqërisë.

Për besimtarin islam, Kur'ani, Fjala Hyjnore, është ligj psikologjik, është shpirti, virtyti që i jep jetë trupit të njeriut. Me këtë ai pasqyron karakterin e tij në ndërtimin e jetës. Shkeljet e ligjeve të virtytit, mosrespektimi i tyre në këtë botë ka më tepër ndëshkim moral si turpin përpara të tjerëve, degradimin e personalitetit si njeri, ndërsa në botën tjetër do të marrë ndëshkimin më të rëndë nga Autoriteti Absolut.

Prandaj, përqaftimi i Islamit është një nga elementet e rëndësishëm në personalitetin e njeriut për të mishëruar në të ato veti të larta morale, që pasurojnë botën e brendshme shpirtërore të tij. Në të përfshihen ndjenjat, idealet, interesat, bindjet që manifestohen në jetën e përditshme në marrëdhënie me të tjerët. Personaliteti përfshin dhe elemente të pavetëdijes që mund të çojnë në fenomene negative, por që thirrja e ndërgjegjes së besimit për vetëkontroll do të korrigojë çdo gjë. Mendja drejton forcën e korrigjimit dhe harmonizon cilësitë e personalitetit të njeriut në zbulimin e tij shpirtëror, moral e fizik.

SAHABËT ME RADHË BËHEN MYSLIMANË ME FTESËN E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (II)

Halid bin Said bin el-Asi bëhet mysliman

Siç na e rrëfen e bija, Halid bin Saidi kishte parë një ëndërr dhe kish qenë kjo ëndërr që e pati çuar drejt besimit, e ai u qe bërë mysliman. Ja se si ishte ajo ëndërr që kishte parë ai: "Dukej sikur Mekën e kishte mbuluar një errësirë e plotë. Aq errësirë ishte, saqë njerëzit nuk arrinin të shihnin as atë që kishin në duar. Kur, një çast, nga burimi i Zemzemit drejt qiellit u lartësua një dritë, që e ndriçoi të gjithë hapësirën përreth Qabes. Mandej, ai nur e kaploi mbarë Mekën. Ajo dritë u drejtua kah hurmishtet e Jethribit (Medinës), duke e mbushur edhe qiellin e saj plot dritë. Një dritë aq e fortë, saqë syri mund të dallonte çdo kokërr hurme të varur në pemë."

Halid bin Saidi, kur u zgjua, ia pati treguar ëndrrën e tij edhe të vëllait, Amr bin Saidit. Amri ishte njeri i ditur dhe largpamës.

- "Vëllai i dashur! Diçka shumë e madhe e pret fisin e Abdulmutalibit. Nuk e sheh, kjo dritë që ti po më tregon mua ka dalë pikërisht nga ai burim që e kanë hapur etërit e tyre me aq mund.", - iu përgjigj i vëllai.

Halidi na e thotë vetë:

- "Ishte pikërisht kjo ëndërr që më udhëzoi mua, duke më çuar drejt pranimit të fesë islame."

Kurse, kur nëna e Halidit shkoi për t'ia treguar të Dërguarit të Allahut këtë ëndërr që kishte parë i biri, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati thënë:

- "O Halid! Pasha Zotin, ajo dritë jam unë dhe unë jam i Dërguari i Allahut." Dhe, prej kësaj thirrjeje të Resulullahut, i biri e pranoi menjëherë Islamin, duke u bërë kështu një ndër myslimanët e parë.

Ëndrra që ka parë Halid bin Saidi është pak më ndryshe sipas një transmetimi tjetër: Në ëndërr Halid bin Saidi qëndronte ndanë një zjarri që vetëm Allahu e dinte, babai i tij përpiquej ta shtynte drejt atij zjarri, ndërsa ai shihte se ai vetë i kërkonte ndihmë të Dërguarit të Allahut, që ta mbronte e të mos e linte që të binte në atë zjarr përvëlues. Nga frika i del gjumi dhe fjalët e para që thotë janë: "Beto hem për Zotin, se kjo ëndërr është një ëndërr e vërtetë." Takohet me Ebu Bekrin (radjallahu anhu) dhe ia tregon edhe atij ëndrrën që ka parë. Ebu Bekri i thotë:

- "Allahu e bëftë hajr. Ai është i Dërguari i Allahut. Nxito të bëhesh edhe ti një prej ndjekësve të tij. Ke për të parë, se edhe ti do të jesh shumë shpejt një prej njerëzve që kanë besuar tek ai, duke u bërë menjëherë mysliman. Ai që përpiket të të ruajë prej zjarrit në ëndërr nuk është askush tjetër, pos Islamit. Kurse babai yt nuk do të besojë, dhe do të hyjë në zjarr." Pas këtyre fjalëve, Halid bin Saidi u takua me Krenarinë e Gjithësisë në lagjen e quajtur Exhjad, dhe e pati pyetur:

- "O Muhamed! Për ku na fton ti ne?"

- "Unë ju ftoj ju për tek Allahu, që është Një i Vetëm dhe që nuk ka shok tjetër si Vetja, dhe që të pranoni se Muhamedi në fillim është robi, pastaj i Dërguari, i Allahut në Tokë. Të ftoj që t'i qëndrosh sa më larg adhurimit të atyre idhujve të bërë vetë prej gurit, të cilët as që janë në dijeni se ka njerëz që i adhurojnë, që nuk mund të sjellin as dobi e as dëm për njeriun, pasi as nuk shohin, as nuk dëgjojnë."

Pas këtyre fjalëve, Halid bin Saidi nuk vonoi dhe tha:

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Dhe, dëshmoj se Ti je i Dërguari i Allahut." Këto fjalë e gëzuan pa masë Profetin tonë (alejhis'salatu ue sel'lem).

Kur e mori vesh i ati, se Halidi ishte bërë mysliman, Halidi filloi të mos shfaqej më shumë para babait të tij, duke lëvizur më tepër nëpër rrethinat përreth Mekës. Dhe, kur sahabët emigruan për herë të dytë në drejtim të Etiopisë, ndër të parët që emigruan ishte edhe ai.

Babai i Halidit, Said bin el-As bin Umejeja, pati ngarkuar një nga djemtë e tij të tjerë, që nuk ishte mysliman dhe skllavin e tij Rafiun, që ta gjenin dhe t'ia sillnin në shtëpi të birin e bërë mysliman. Pas njëfarë kohe ata e gjetën Halidin dhe e prunë para të atit.

- "Megjithëse e pe që Muhamedi vepron kundër popullit të tij, duke i turpëruar atyre zotat dhe duke i poshtëruar ata të gjithë në sytë e njerëzve, ti prapëseprapë iu binde atij, kështu hé?"; - i tha babai atij, i nxehur dhe duke i bërtitur e duke iu kanosur. E goditi me një copë druri që mbante në dorë dhe nga koka nisi t'i rridhte gjak. Megjithatë, Halidi nuk hoqi dorë nga e tija dhe i tha babait:

- "Ai thotë të vërtetën, ndaj po, unë i bindem atij."

Kjo ia shtoi edhe më shumë nevrkosjen të atit, duke e bërë që ai t'i thoshte të birit:

- "I poshtër! Shko ku të duash! Unë nuk të jap më të hash."

- "Mos më jep, edhe po nuk më dhe ti mua, është Allahu që do të më ushqejë!"

Saidi e përzuri jashtë Halidin dhe i paralajmëroi të gjithë djemtë e tjerë:

- "Me të nuk do të flasë më askush. Nëse marr vesh se ndonjëri prej jush i afrohet dhe i flet, ta dini se atë që i bëra atij do t'ua bëj edhe atyre që do të flasin me të."

Halidi shkoi drejt e tek i Dërguari i Allahut. Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e mori pranë dhe që nga ajo ditë nuk e ndau më nga vetja.

Babanë e Halidit (radjallahu anhu), Said ibnu'l-As bin el-Umejjen dikur e zuri një sëmundje dhe ai pati thënë:

- "Nëse Zoti do të më ngrejë një ditë nga shtrati i kësaj sëmundjeje, do të bëj që zoti i të birit të Ebu Keshes – duke pasur parasysh Resulullahun me këto fjalë – të mos adhurohet më kurrë në Mekë." Ndërsa i biri, Halidi, e mallkoi duke thënë:

- "O Zot! Mos i fal asnjë të mirë këtij njeriu!" Në të vërtetë as ai nuk arriti që të shpëtonte dot më prej sëmundjes që e pati kapur, derisa vdiq.

Dimadi (r.a.) bëhet musliman

Dimadi i përkiste fisit të Edhdishenues. Ai merrej me magji. Pati ardhur në Mekë për të vizituar Qaben. Kur dëgjoji që shumë njerëz të pamend në radhët e mekasve thoshin për Krenarinë e Gjithësisë "është i çmendur", nuk ngurroi, por i pyeti menjëherë:

- "Ku është ai njeri? Ndoshta Zoti e shpëton atë me ndonjë shërim që mund t'i vijë nga duart e mia?"

Ja se si e tregon ai vetë se çfarë ndodhi atë ditë: "Isha ulur në një vend me Ebu Xhehlin, Utbe bin Rebian dhe Umeje bin Halefin. Ebu Xhehli tha:

- "Ja ku është ai njeri që na e ka prishur bashkimin, duke na përçarë, që e ka tepruar dhe po na bën gazin e botës, duke na e quajtur të shthurur të shkuarën e lavdishme e që nuk ka lënë asgjë pa thënë për zotat tanë."

- "Nuk ka më asnjë dyshim, ky njeri është çmendur!", – tha Umejje bin Halefi.

Më bënë shumë përshtypje këto fjalë të Umejes.

Të pranishmëve u thashë se unë "mund t'i fryja e ta shëroja" dhe menjëherë u largova së andejmi. Fillova të kërkoja për të, por më kot, sepse atë ditë nuk e gjeta dot. Ditën tjetër shkova pranë vendit të Ibrahimit në Qabe dhe e gjeta duke u falur, në pozicion ulur. Prita pak, sa të mbaronte së faluri. Kur mbaroi faljen iu afrova pranë dhe i fola:

- "O nipi i Abdulmutalibit!"

- "Më thuaj, si mund të të ndihmoj?", – më tha.

- "Fryma ime është e mirë dhe unë mund të të bëj magji duke të fryrë. Po të duash, mund të të shëroj duke përdorur mënyrat e mia të shërimit. Hë, si thua, mos lejo që gjendja në të cilën je të përkeqësohet! Unë kam shëruar edhe shumë të tjerë, të cilët kanë qenë shumë herë më keq se ty! I kam dëgjuar të gjitha se ç'thotë populli yt për ty, e të gjitha ishin gjëra jo shumë të hijshme; disa thonë 'e ka tepruar, e na ka poshtëruar në sytë e

njerëzve', disa të tjerë thonë 'na ka përçarë', disa të tjerë thonë 'ai na e fajëson të shkuarën me mëkatin e shthurjes', e disa të tjerë thonë 'ai po na i përbuz të gjithë zotat që ne besojmë'. Kur i pyeta ata se përse e bëje këtë gjë, ata më thanë se 'ishe çmendur'. Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili i kishte dëgjuar të gjitha fjalët që thoshte ky njeri, i tha:

- "Lëvdimi i takon vetëm Allahut. Unë e lëvdoj Allahun dhe përherë vetëm prej Tij kërkoj ndihmë. Unë tek Ai kam besuar dhe tek Ai jam dorëzuar i tëri me mish e me shpirt. Atë që e udhëzon Ai, askush nuk mund ta devijojë nga rruga e drejtë e së vërtetës. Dhe këdo që Ai e nxjerr nga rruga e duhur, atë nuk ka më fuqi që ta udhëzojë kah e drejta. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut. Ai është Një. Nuk ka as shok, as ortak, në krijimin e gjithçkaje."

- "Të betohem, se deri më sot nuk kam dëgjuar ndonjëherë fjalë më të bukura se këto që më the ti tani!", – i thashë të Dërguarit të Allahut, duke i kërkuar nëse mund t'i përsëritë edhe njëherë. Ai m'i përsëriti edhe njëherë.

- "Për ku na fton ti ne?", – e pyeta unë.

Resulullahu u përgjigj:

- "Unë ju ftoj ju që ju t'i besoni Allahut, se Ai është Një dhe i Vetëm dhe që nuk ka asnjë shok a të ngjashëm me Vetën; që t'i nxirri idhujt nga jeta juaj dhe të dëshmoni se unë jam i Dërguari i Allahut."

- "Po nëse unë i pranoj të gjitha këto, çfarë më premtohet mua?", – vijova ta pyesja.

- "Parajsa e përjetshme!", – m'u përgjigj.

Nuk kisha se ç't'i thosha veçse:

- "Nuk kam asnjë dyshim dhe me sinqeritet e pranoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut. Ai është Një, i Vetëm. Është i Pashoq. Po i nxjerr nga jeta ime të gjithë idhujt që kam dashur gjer më sot, duke u larguar njëherë e mirë syresh. E po ashtu dëshmoj se ti je rob i dhe i Dërguari i Tij."

Dimadi, i cili po i bindej e po i jepte besën të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në emër të vet dhe të të gjithë fisit të tij, qëndroi pranë Resulullahut edhe për njëfarë kohe. Pasi mësoi një numër të konsiderueshëm suresh nga Kur'ani, u nis për t'u kthyer pranë fisit të tij.

Nga ajo çfarë na është transmetuar kuptohet se të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pati pëlqyer shumë sinqeriteti i fjalëve të Dimadit, ndaj edhe ishte i bindur se Dimadi kishte tashmë një besim të shëndoshë, sepse grupi i armatosur që kishte ngarkuar me detyrë i Dërguari i Allahut pati shkuar edhe pranë fisit të Dimadit. Komandanti i këtij grupi i pati pyetur ushtarët:

- "A morët dot gjë prej atij fisi?"

- "Po!", – qe përgjigjur njëri nga ushtarët, – "morëm një tullumb me ujë."

- "Atëherë, të ktheheni e t'ua jepni mbrapsht, sepse ai është fisi i Dimadit", – pati thënë komandanti dhe ushtarët e patën kthyer mbrapsht atë çfarë kishin marrë prej njerëzve të Dimadit.

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandeheui

Botim i KMSH

Haxhi

DHE ROLI I TIJ MORAL, EDUKATIV E SHPIRTËROR

Haxhi është shtylla e pestë themelore e fesë Islame me të cilën Allahu i Lartësuar i ka plotësuar rritoret dhe obligimet që duhen zbatuar. Në Kur'an, Zoti i Lartësuar thotë: "Vizita e Qabes për hir të Allahut është detyrim për atë që ka mundësi." (3: 97)

Haxhi është tubimi më i madh vjetor islam dhe botëror, në të cilin takohen myslimanë të vendeve, etnive, kulturave dhe traditave të ndryshme, të gjithë synojnë një qëllim: arritjen e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar. Në të demonstron unitetin, barazinë, solidaritetin, devotshmërinë dhe madhështinë e bashkësisë myslimane.

Haxhi është një moment ekskluziv i eliminimit të të gjitha diferencave nacionale, racore dhe klasore. Në të shpalosen vlerat e vëllazërimit islam dhe të barazisë sociale, pasqyrohen idealet, simbolet dhe virtutet morale, si: devotshmëria, sakrifica, bamirësia e sinqeriteti. Haxhi është një edukim njerëzor për barazi sociale. Njerëzit aty janë të barabartë, të gjithë kanë veshje të njëjtë, dy pëlhura të bardha të njohura si

rroba të ihramit. Qëllimi është që njeriu t'i veshë rrobat natyrore dhe të stërvitet për kuptimin e barazisë. Të gjithë qëndrojnë në fushën e Arafatit, të gjithë janë të barabartë para Allahut xh.sh. Për këtë Profeti ka thënë në ligjëratën e tij të lamtumirës: "O njerëz! Vërtet, Zoti juaj është Një dhe babai juaj është një. Kujdes! Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit, as i kuqi ndaj të ziut, as i ziu ndaj të kuqit përveçse në devotshmëri."

Është ky një demonstrim i universalitetit të kësaj feje dhe i vëllazërimit të përgjithshëm të myslimanëve nga kudo që të kenë ardhur. Është ky akti i përkushtimit të përbashkët ndaj Zotit duke reflektuar gatishmërinë për t'i sakrifikuar interesat shpirtërore e materiale në shërbim të Allahut të Lartësuar.

Haxhi është përkujtim i njerëzve për babanë e profetëve, Ibrahimin a.s., që e ka ndërtuar shtëpinë e shenjtë, Qabën, në të cilën njerëzit e kryejnë Haxhin. Kjo shtëpi është ajo që Allahu i Lartësuar e ka obliguar çdo mysliman të drejtohet nga ajo pesë herë në ditë. Në



Kur'an thuhet: "Dhe ngado që të dalësh, ktheje fytyrën tënde nga ana e xhamisë së shenjtë (Qabes) dhe kudo që të gjendeni, ktheni fytyrat tuaja nga ana e saj" (2: 150).

Institucioni i haxhit ndër të tjera ka një karakter edukativ shumëdimensional. Allahu i Madhëruar e ka bërë këtë rit të veçantë. Në të myslimani përfiton energji shpirtërore, emocionale dhe sentimentale, rilind personaliteti i tij njerëzor, rikthehet me zemër të pastër dhe të dëlirë, i penduar për mëkatet e bëra. Profeti a.s. ka thënë: "Kush e kryen haxhin, duke mos shkelur kushtet e tij, kthehet nga mëkatet e tij si në atë ditë që e ka lindur nëna e vet."

Në aspektin e edukimit social haxhi është konferenca më e madhe e paqes që njihet në historinë e njerëzimit. Udhëtimi i Haxhit është një udhëtim i paqes, në tokën e paqes dhe në kohën e paqes. Vendi i Haxhit është vend i paqes: Toka e shenjtë, Qabeja, është Shtëpia e ndalimit të konflikteve, kushdo që hyn në të, është i sigurt; "Dhe kur Shtëpinë (Qaben) e bëmë vend kthimi dhe vend

sigurie për njerëzit." (Bekare, 125)

Koha e Haxhit është kohë e paqes, sepse rituali i pelegrinazhit kryhet në muajin e shenjtë të Haxhit. "O ju që besuat! Mos i shkelni simbolet e Allahut, as muajin e shenjtë (mos lejoni luftë), as kurbanin (mos e pengoni)..." (Maide: 2)

Haxhi është kongresi hyjnor për bashkësinë myslimane. Në të mblidhen myslimanë nga Lindja e Perëndimi. Ai është një kongres, mikpritës i të cilit nuk është ndonjë mbret apo president, por Zoti i botëve, Allahu i Lartësuar. Apeli i Tij hyjnor i fton njerëzit në këtë kongres, që të takohen e të bashkohen në një fjalë, në fjalën "Islam".

Institucioni i Haxhit ka një rol të rëndësishëm në ndërtimin e karakterit të jetës njerëzore. Nga ai nxirren mësimet e dobishme dhe që mbeten të përjetshme në memorien e besimtarëve. Nëpërmjet këtyre mësimëve ne si besimtarë edukohemi moralisht, lartësohemi shpirtërisht dhe bëhemi të denjë për kënaqësinë dhe nderimin e Allahut të Lartësuar në të dy jetët.



Familja,

themeli bazë i bashkësisë njerëzore

Familja është institucion i frymëzuar nga Zoti i paraqitur qysh me krijimin e njeri- ut. Ajo nuk është zhvilluar përmes proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Kjo është një e vërtetë e kumtuar nga mësimet hyjnore të shpallura nga Zoti dhe është

refuzim i tërësishëm i mësimëve evolucioniste, sipas të cilave jeta e njeriut ka filluar në ujë me bashkimin e rastësisht të miliona proteinave për të krijuar qelizën e parë të jetës.

Raca njerëzore është prodhim i këtij institucioni e nuk është institucioni prodhim i racës njerëzore. "O njerëz, bëhuni respektues e të bindur ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shume burra e gra. Kini frikë Allahun në emrin e të Cilit përбетoheni. Vërtet, Allahu është Mbikëqyrësi juaj..."

Familja është sistemi më i vjetër shoqëror, sepse ajo arrin deri te familja e parë e Ademit (paqja qoftë mbi të!), e cila ishte bërthamë e tërë shoqërisë njerëzore.

Familja në secilën fe dhe secilin rregullim social pranohet si gurëthemel në shoqëri.

Edhe feja islame shumë shpesh fokusohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës boheme, sepse familja është vendi ku natyra njerëzore mundet ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mundet t'i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta si: dashuria, respekti, dhembshuria, sakrificë, besnikëria dhe bindja. Afërsisht një e treta e rregullave juridike të

Kur'anit kanë të bëjnë me familjen dhe rregullimin e harmonisë së saj.

Kurani tregon për ambientin e qetësisë, prehjes shpirtërore, të mëshirës dhe të dashurisë, të cilën e formon sistemi familjar dhe ai e bën këtë sistem një argument prej argumenteve të urtësisë, të fuqisë dhe të madhësisë së Allahut.

"Dhe nga shenjat e (madhësisë së) Tij është për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë." (30: 31)

Sistemi i familjes islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të të afërmeve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imëta. Ai ushqen tek individi bujarinë, dashurinë dhe sjelljet joegoiste në kuadrin e një familjeje të

organizuar mirë. E gjithë kjo ka për qëllim që shoqëria myslimane të ndërtohet mbi themele të shëndosha, pasi qetësia dhe siguria e ofruar nga një familje e stabilizuar ka vlerë të jashtëzakonshme dhe është thelbësore për anëtarët e saj.

Pa ekzistencën dhe përkrahjen e një familjeje të shëndoshë nuk mund të realizohet kurrë harmonia në

një shoqëri.

Vetëm në kuadër të familjes potenciali shpirtëror i burrit dhe gruas bëhet realitet dhe zhvillon pastërtinë morale brenda dhe jashtë saj.

Familja në kontekstin islam është një strukturë e veçantë, parimet e së cilës janë lidhur me njëritjetrin përmes lidhjeve të gjakut dhe marrëdhënieve bashkëshortore, lidhshmëria e të cilave është e një natyre të atillë sa të kërkojë "kërkesa të ndërsjella", që janë caktuar nga feja, të përforcuara nga ligji dhe të ndërtuara nga individi.

Struktura familjare në fenë islame është e ndërtuar mbi baza të shëndosha, me qëllim të suksesit dhe vazhdimësisë së saj. Këto baza janë:

1. Besimi. Me anën e besimit dhe Sheriatit, secili nga bashkëshortët i di të drejtat dhe obligimet e veta dhe ka para vetes një program të qartë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Burri dhe gruaja plotësojnë njëritjetrin dhe respektimi i përbashkët i vlerave të martesës dhe besnikëria në mes

bashkëshortëve janë elementet kryesore që e fuqizojnë paqen dhe harmoninë në jetën bashkëshortore.

Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Më i miri (më i dobishmi) prej jush është ai që është më i mirë për gruan (familjen e tij), e unë jam më i miri nga ju për familjen time". Po ashtu ka thënë: "Kjo botë është kënaqësi dhe kënaqësia më e mirë e saj është gruaja e mirë. Kur e shikon atë, e gëzon, kur i kërkon diçka e dëgjon dhe, nëse nuk është i pranishëm, ia ruan nderin dhe pasurinë".

2. Martesa me pëlqim të dyanshëm, sepse vetëm një martesë e tillë do të jetë e sukseshme.

Islami e ndaloj imoralitetin dhe ndërrmori masa të ashpra për ndalimin e tij, sepse imoraliteti është sulm i hapur ndaj sistemit të familjes dhe shenjtërisë së saj. Kështu, Islami hapi dyert për formimin e familjeve duke iu përgjigjur natyrës së njeriut me të cilën Allahu i krijoi njerëzit.

Kur'ani shpjegon se martesa ishte traditë e pejegambereve në ajetin vijues:

"Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësua të kishin gra e fëmijë..." (13: 38).

Në ditët tona familja, e cila është epiqendra e shoqërisë, ndodhet përballë një sërë sulmesh bashkëkohore. Tregtarët e epshit, të cilët pandehin se mbrojnë të drejtat e vajzave dhe grave, duke zhvilluar armiqësi veçanërisht ndaj Islamit, në çdo rast të përshtatshëm e paraqesin martesën si të keqe dhe kërkojnë të asgjësojnë ndikueshmërinë dhe efektivitetin e familjes. Një numër i madh

njerëzish të rënë në grackën djallëzore të ngritur nga ata që e përdorin femrën si mjet kënaqësie e dëfrimi, duke u dhënë pas kërkimeve jashtë familjes dhe Islamit, kryejnë të gjitha llojet e mëkateve në emër të të ashtuquajturit qëndrim bashkëkohor.

Prandaj, martesë është e vetmja mënyrë që bashkëshortët në jetën e tyre të përbashkët të gjejnë kënaqësinë dhe qetësinë e tyre, ta plotësojnë njëri-tjetrin, ndërmjet tyre të ketë dashuri dhe butësi të ndërsjellë, të bëjnë mirëmbajtjen e brezave të ardhshëm dhe të kryejnë të tjera detyra madhështore.

Jeta bashkëshortore është themeli i familjes, kurse familja themeli i bashkësisë njerëzore.

Se sa e rëndësishme është, për sa i përket njeriut, familja e formuar si rezultat i martesës, pohohet me këto fjalë në Kur'an:

"...ato janë prehe për ju dhe ju jeni prehe për ato..." (Bekare, 187)

Profeti Muhamed a.s. në lidhje me këtë thotë:

"Kush ka mundësi për martesë, le të martohet, ngase martesë i mbron sytë nga harami deri në pikë të fundit. Gjithashtu e ruan nderin dhe moralin deri në një shkallë. Ndërsa kush nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë pasi agjërimi e shuan epshin".

3. Përgjegjësia e përbashkët. Martesë obligon përgjegjësi të caktuar, të cilat i përkufizon Sheriati.

Për këtë feja islame i jep rëndësi hapave të parë të krijimit të familjes duke zgjedhur elementet e shëndoshë, të cilët do të mbajë shtrënguar fort nyjen e shenjtë (lidhjen martesore).

Po cila është përgjegjësia themelore e burrit dhe gruas?

Ato zëbërthehen në terma të gjerë e të përgjithshëm. Me qëllim që të mos ketë anarki dhe çrregullim në udhëheqjen e çështjeve të familjes. Islami udhëheqjen e këtij institucioni dhe mbrojtjen e tij ia caktoi burrit, pasi ai është më i fortë që të ballafaqohet me vështirësi dhe peripecitë e punëve të

ndryshme gjatë kërkimit të rrizkut në tokë dhe gjithashtu, sepse burri ka një përvojë më të madhe në njohjen e gjendjes së njerëzve dhe të jetës për shkak të natyrës së krijimit të tij dhe rolit të tij në shoqëri.

Allahu i Madhëruar thotë: "Burrat janë mbrojtësit dhe mbajtësit e grave".

Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet si sundim apo nënshtrim, por do të thotë sistematizim e radhitje e përgjegjësive, pasi ideja për superioritetin mashkullor në raport me atë femëror, në fenë islame nuk qëndron, ngase kodi islam ka rregulluar mjaft mirë raportet mes burrit dhe gruas ku secilit prej tyre i ngarkoi përgjegjësi të ndara, jo për ta ulur njëri-tjetrin, por për t'u relizuar formula

hyjnore "gjetja e prehes dhe e qetësisë mes njëri-tjetrit".

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Të gjithë jeni rojtarë dhe të gjithë jeni përgjegjës për të drejtat e atyre që janë në kujdesin tuaj. Udhëheqësit janë përgjegjës për gjithë atë që është nën pushtetin e tyre, përgjegjësi i familjes është përgjegjës për anëtarët e familjes së vet, ndërsa

gruaja është përgjegjëse për familjen e saj."

Ndërsa përgjegjësitë e gruas janë:

Së pari, ajo ka përgjegjësi për kultivimin e situatës së shëndoshë në shtëpi për burrin dhe për fëmijët. Ajo është që dikton disponimin se si do të udhëhiqet shtëpia e si do të krijohet një atmosferë të shëndoshë e të qetë për familjen e saj.

Në Islam, burri për gruan e tij dhe gruaja për burrin e saj janë si një pëlhurë, e cila mbron secilin nga çdo gjë jashtë tyre. Kjo mbulesë përfshin të gjitha aspektet, qofshin shpirtërore apo materiale.

Së dyti, përgjegjësia e saj është në rritjen e fëmijëve dhe edukimin e tyre. Përgjegjësitë e saj shtrihen deri në ballafaqimin me fëmijët, edukimin e tyre, të mësuarit atyre sjelljen, mbrojtjen e tyre, si dhe dallimin e asaj se ç'është mirë dhe ç'është e keq. Duke i kultivuar të gjitha këto aspekte të rëndësishme në jetën e tyre të përditshme ata do të rriten në mënyrë të pastër dhe të sigurt. Allahu

thotë në Kur'an: "O ju që keni besuar! Mbrojeni veten tuaj dhe familjet tuaja (do të thotë fëmijët, çiftin dhe kështu me radhë) nga zjarri."

Ndërsa i dërguari i Zotit porositi: "Fëmija edukohet 20 vjet para lindjes së tij", pra me edukimin e prindërve të tij.

Familja është shkolla e parë për edukimin e fëmijëve dhe se fëmija ka nevojë të domosdoshme për dashurinë e saj, ngase ajo e rrit, e frymëzon dhe i jep vullnet atij. Këtë e shohim në rastin kur familja është e shëndoshë, në shpirtin e fëmijës kultivohen ndjenjat e dashurisë, respektit, bashkëpunimit, vullneti i mirë për të tjerët, puna për të mirën e përgjithshme, si dhe sakrifica për hir të parimeve të larta.

Hulumtimet e shumta shkencore vërtetojnë se shumica e atyre që kanë devijuar dhe janë zhytur në rrugën e kriminalitetit, janë ata që nuk kanë pasur rastin të shijojnë ngrohtësinë familjare, si dhe nuk kanë pasur rast të edukohen me vlerat dhe ndjenjat e jetës së familjes së shëndoshë.

Dashuria dhe harmonia në martesë dhe në familje ku çdo anëtar i familjes i përmbush detyrat e tij familjare, është kënaqësi e vërtetë.

Joharmonia në familje rrjedh nga lënia e detyrimeve dhe përgjegjësive ndaj familjes si dhe nga mungesa e vetëdijes, e cila shkaktohet nga shkalla e ulët e edukatës morale, e pirjes së alkoolit dhe jobesnikërisë bashkëshortore.

Feja islame ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha në shoqëri. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve shoqërore dhe morale dhe që mos shkojmë deri te shkatërrimi i familjes prej shtresave ideologjike, të cilat mundohen të depërtojnë në familjet tona, ne duhet ta forcojmë strukturën familjare.

Familja është institucion që i zhvillon lidhjet farefisnore ose të gjakut mes njerëzve, që i shndërron këto lidhje, në

masë të madhe, në solidaritet shoqëror-ekonomik dhe mbështetje të dyanshme. Ka plot tekste kuranore dhe profetike që na obligojnë për sjellje të mirë, vizitë dhe kujdesje ndaj prindërve si dhe ndaj të afërmve.

Allahu i Madhërishëm thotë: "Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mirë ndaj prindërve të vet." dhe "Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë, që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë të denjë ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapluar pleqëria pranë kujdesit tënd,

atëherë mos u thuaj atyre as 'Of-Oh', as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj:

"Zoti im, mëshiroji ata të dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël." (Isra: 23-24) Muhamedi (a.s.) ka

thënë: "Mëkate të mëdha janë: t'i bësh shirk Allahut të Madhërishëm, mosrespektimi i prindërve dhe e vrasja e njeriut të pafajshëm".

Familja renditet në krye të institucioneve që kontribuojnë në njohjen e brezave me vlerat islame si dhe në formimin e shëndoshë dhe të qëndrueshëm të ndërrimeve shoqërore. Familjet e ngritura mbi vlera të larta si besnikëria, dashuria e singertë, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur, janë garancia më e madhe e shoqërisë islame. Fundja, ekzistenca e një institucioni matet me aktivitetin e tij.

Prej familjeve të lumtura burojnë rrezet e lumturisë në mbarë shoqërinë njerëzore, kurse fatkeqësinë e familjeve jo të lumtura e përjeton e tërë bashkësia apo shoqëria njerëzore.





TË JETOSH
Sunetin

Në Haxhin e Lamtumirës, Profeti a.s. mes të tjerash tha: "O njerëz, ju kam lënë dy gjëra të cilat nuk do t'ju lejojnë të gaboni nëse kapeni pas tyre: Kur'anin dhe sunetin (shembullin) tim".

Jo pa qëllim suneti përmendet bashkë me Kur'anin në këtë fjalim të rëndësishëm të Profetit a.s., pak kohë para se të ndërronte jetë. Kur'ani pa sunetin nuk ka se si të kuptohet, sepse suneti përfaqëson interpretimin praktik të Kur'anit. Kështu, kur Aishja u pyet rreth sjelljes së Profetit a.s., tha: "Sjellja (moral) e tij ishte Kur'ani", përgjigje kjo që tregon se suneti i Profetit a.s. nuk ishte veçse mishërim besnik i parimeve të Kur'anit. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i udhëzon besimtarët në ndjekjen e tij duke thënë: "Vërtet jeta e të Dërguarit të Allahut është një shembull i mirë për atë që shpreson në shpërblimin e Allahut, në botën tjetër, dhe e përmend shumë Allahun." (33:21)

E veçanta e sunetit është se ai shtrihet në tërë gjerësinë e jetës duke mos lënë jashtë as veprimtarinë më të zakonshme të jetës së përditshme. Duke pasur një shtrirje të tillë, udhëzimi për zbatimin e sunetit duket sikur sjell një sforcim të panevojshëm për myslimanin. Kështu, ç'ndryshim do të kishte ngrënia me të djathtën apo të majtën nëse të dy duart janë të pastra?

Kësaj dileme i përgjigjemi: Duke zbatuar sunetin, myslimani jeton në mënyrë sistematike në një gjendje ndërgjegjësimit dhe disiplinimi të brendshëm. Ato punë dhe vepra që kryhen në mënyrë automatike e pengojnë përparimin shpirtëror ashtu siç gurët i pengojnë kuajt gjatë garës.

Këto punë dhe sjellje duhet të pakësohen në maksimum, sepse ato e shkatërrojnë orientimin shpirtëror të mendimeve. Çdo veprim që kryejmë duhet të jetë nën kontrollin tonë shpirtëror. Por para se të arrijmë këtu, duhet të mësojmë se si të kontrollojmë veten

tonë. Domosdoshmërinë e këtij vetëkontrolli e shpreh i Dërguari i Allahut në thënien e tij: "Adhuroje Allahun ashtu sikur ta shihje".

Qëllimi i adhurimit në Islam është bashkimi i aspekteve materiale dhe shpirtërore të jetës sonë në një të vetme. Për këtë arsye, përpjekjet tona duhet të drejtohen qartësisht te pakësimi i veprimeve që kryhen automatikisht dhe pa vetëdije të brendshme aq sa lejojnë mundësitë njerëzore. Hapi i parë në këtë rrugë është kërkimi llogari vetvetes dhe mënyra më e mirë për praktikimin e saj, është vënia nën kontroll e veprimeve të kthyer në zakone, të cilat i kryejmë në jetën e përditshme pa ndonjë vëmendje të dukshme. Këto veprime të "parëndësishme" në dukje janë më të rëndësishme për ushtrimin mendor për të cilin po flasim sesa veprimet trupore, ngase këto të fundit janë të dukshme dhe në përgjithësi i kryejmë në mënyrë të ndërgjegjshme, ndërsa punët e "vogla" i shpëtojnë vëmendjes sonë.

Kështu, mbase nuk është e rëndësishme në vetvete që ne të hamë me njërën apo tjetrën dorë por, nëse marrim parasysh kontrollin e vetvetes, kryerja e veprimeve në mënyrë sistematike është nga gjërat më të rëndësishme. Nuk është aspak e lehtë që njeriu të qëndrojë gjithmonë në gjendje vëmendjeje të vazhdueshme ashtu që të mund ta ketë veten nën kontroll. Përtacia e mendjes nuk ndryshon në esencë nga përtacia e trupit. Nëse një personi të ambientuar me pak lëvizje i kërkohet të përshkojë një farë distance, ai do lodhet shumë shpejt, në ndryshim nga ai që është mësuar të ecë. Ky shpjegim i thjeshtë na sqaron pse suneti përfshin çdo aspekt të jetës. Nëse çdo gjë që bëjmë apo lëmë pa bërë i nënshtrohet një dallimi të qartë racional, atëherë prirja dhe aftësia jonë për të disiplinuar veten do të rritet gradualisht derisa të bëhet natyra jonë e dytë.

Puna, përpjekja dhe koha e tyre

Profeti i naltë a.s. urdhnon:

“Me u përpjek për me fitue në mënyrë të ligjshme asht detyrë e domosdoshme mbi çdo mysliman.”

Profiti i naltë, edukuesi moral e material, Hz. Muhamedi a.s. me këtë traditë të shkurtër na urdhnon se, duhet të përpiqemi për sigurimin e jetesës dhe se kjo përpjekje asht detyrë e domosdoshme mbi çdo mysliman; e bashkë me këtë na tregon se përpjekja duhet të jetë për çdo herë e pajtueshme me moral. Fjala përpjekje në hadithin e sipërm asht lidhë me fjalën Hallall; nga kjo lidhje kuptohet se përpjekja për sigurimin e jetesës duhet të bahet me drejtësi, me njerzi, me besnikëri e në mënyrë të pastër. Veç kësaj, nga mënyra e formimit të fjalës qi përmban tradita, në bazë të rregullave të literaturës arabe, nxjerret edhe ky kuptim: “Përpjekja lypset të jetë e qëndrueshme”. Ky kuptim del mbasi fjalija asht në formën emnore, në gjuhën arabishte “xhublei ismij-je”. Mbi këto baza pra kuptimi i vërtetë i hadithit asht:

“Përpjekja për sigurimin e jetesës asht një detyrë e domosdoshme mbi çdo mysliman, që duhet të bahet me drejtësi, me njerzi, me sinqeritet, me fisnikëri e plotësisht në mënyrë të kullutë; dhe e qëndrueshme.”

Qe kjo asht pra një nga detyrat që porositi punën në mënyrë të domosdoshme dhe të qëndrueshme krahas me moral deri në fund të gjallnis.

Puna dhe përpjekja në fen Islame kanë shumë randsi. Urdhnat Hyjnore dhe porositi Profetike rreth kësaj gjaje janë të panumërta.

Feja Islame punën e ka ba si një shtyllë themelore për sigurimin e lumnis së çdo njeriu e të çdo populli. Sa më tepër që të jetë përpjekja me drejtësi e në mënyrë të kullutë, aq ma tepër lulëzon e mbara dhe vazhdon fatbardhësia. Jeta e një familje në kënaqësi, vazhdimi i një shoqërie në rregull e në të mirë, përparimi i një kombi në të gjitha mënyrat e dëshirueme, qëndrimi i një shteti në forcë e në pa tundmeni, asht i mvarun me sasin e përpjekjes në punë.

Qe një urdhën Hyjnor që përmban Kur’ani i Shenjtë:

“Me të vërtetë nuk ka për njeriun veç aq sa të ketë përpjekjen”, domethënë sa ka me punue, aq ka me gëzue. Sa ma pastër që ka me veprue, aq ma tepër ka me u lumnu.

Pra nuk ka vend në fen Islame përtacsija. Nuk asht i lejuem të ndejunit kot pa punë e pa përpjekje. Nuk pranohet kurrnji mënyrë me thanë se, rizku m’asht caktue e s’asht nevoja të përpiqem. Ja, ky asht një mendim i kotë, një ide e gabueme, e paarsyeshme dhe pa farë vlefte. Rizku me të vërtetë asht caktue nga i Madhi Zot, por për me mbri në dorë, asht vu si ligjë puna e përpjekja. Ajo fuqi Hyjnore me dijen e Vet të pakufishme, qysh n’amshim i ka ditur punët e nevojat tona, e kështu i ka caktue e vendos rizqet; të cilave për të dalun në shesh e për të himunit të tyre ndër duart e njerëzve, ju ka vu si ligj punën e përpjekjen e njeriut. Pra nuk duhet me u çudit, se caktimi i rizkut dhe urdhri për me punue, të dyja janë prej një burimi, prej thesareve të pafundme të Perëndis së madhnueshëm. Prandaj duhet puna dhe përpjekja për të.

Papunësija, të ndejunit kot, përtacsija janë sende krejtësisht të përbuzuna nga feja Islame. Qe sa bukur na tregon Hadithi

Profetik:

“Ma e tmerrshmja gja që kam frikë për ymetin t’em, asht madhsia e barkut, vazhdimi i gjumit dhe përtacsija.”

Profeti i naltë me këtë traditë na tregon se këto tri gjana janë armiqtë e përpjekjes në punë dhe pengimet e sigurimit të së mirës. Madhsija e barkut, domethënë të mbushurit e barkut me të ngranun përtej sasis së nevojitur, përveç që asht një dam trupor e financiar, por shkakton plogështin e njeriut dhe e ban të përtojë me luftë prej vendi, dhe bashkë me këtë, pjesërisht i qorrin dritën e mendjes dhe ia pengon gjykimin e kulluet. Në këtë mënyrë asht edhe gjumi i tepërt që shkakton vonesën e punës, pse çdo punë ka kohën e vet dhe sasin e caktue e të mjaftueshme. Kur një punë i zen kohën një pune tjetër, natyrisht ajo tjetra mbetet pa u ba, pjesërisht e jo krejtësisht.

Nga përmbajtja e shprehun e kësaj tradite profetike këto tri gjana që janë të papëlqyeshme, prej të cilave myslimani duhet të ruhet që mos t’i bahen ves; por njëkohësisht punës dhe kohës duhet t’u japim randësi të madhe.

Feja Islame asht vetë e mira, jo vetëm shpirtnore e morale, por edhe materiale e shëndetësore. Nuk porositi vetëm adhurimet, por njëherit edhe punimet. Nuk urdhnon njerzinë me përpjekjen për jetën e pasosur, por edhe punimin me këtë e vazhdimin për jetën, brenda së cilës gjendemi. Qe një fakt për këtë të vërtetë që na urdhnon Ai Edukuesi i Naltë moral:

“Nga më të mirët e juaj janë ata që punën e Ahiretit nuk e lanë për punën e dynjasë, dhe punën e dynjasë nuk e lanë për punën e Ahiretit dhe nuk i bahen barrë njerëzis.”

Sa pak fjalë e sa shumë kuptime, por nga kuptimet kryesore janë:

- adhurimet,
- punimet e përpjekjet,
- mospengimi i njani-tjetrit të këtyne dy bazave,
- kujdesi për detyrat e të dy jetëve paralelisht,
- mos të bamunit barrë mbi njerëzin.
- fitesa.

Veç këtyne asht edhe koha, të cilës myslimani duhet t’i japi randsi të madhe, pse brenda saj bahet çdo gja dhe me të janë të mvaruna të gjitha punët. Ajo asht mjeti ma i parë për çdo gja e cila, krejtësisht jo që jo, por edhe pjesërisht nuk duhet të humbatet për kot.

Koha për punë asht si toka për mbjellje. Sikur pa qenë toka nuk ka bimë, ashtu pa qenë koha nuk mund të ketë punë.

Sa bukur ka thënë një dijetar:

“Koha ka shumë randsi
Nuk blehet as me inxhi.”

Mbasi brenda kohe bahet çdo punë, e pa qenë ajo nuk kryhet gja, dhe mbasi ajo ka randsi shumë të madhe, i Madhi Zot betohet në të e thotë:

“Vel Asri” – (Betohe me kohën).

Pra koha ka shumë vlefte e s’duhet të bjerret kot.

Që s’duhet ta pengojnë punët e dynjasë punën e ahiretit, as ajo e ahiretit atë të dynjasë, por secila me u krye në kohën e vet, porositi verseti kuranor që i plotmëshirshmi Perëndi urdhnon:

“Kur të thrrasi ezani për namazin e xhumas, shpejtoni në kryemjen e detyrës dhe leni tregtinë”. Ky urdhën në këtë mënyrë

të premë asht vetëm për namazin e xhuma, që asht një detyrë në të cilën mblidhen muslimanët dhe brenda atyne minutave përveç që kryejnë faljen, por edhe dëgjojnë nga prijësi predikues shumë sende të nevojshme që i përkasin kësaj jete dhe asaj të pasosunës; dëgjojnë sende që janë e mira dhe e mbara vetjake dhe shoqnore që i lypsen njeriut e shoqnisë në çdo çast, në çdo kohë e për çdo punë. Me gjith që për aq minuta lihet tregtia e i duket që nuk mendon se humb punën, porse n'anë tjetër i del dobi ma e madhe.

Por me t'u krye kjo detyrë, nuk duhet me ndej ma por me u shpërnda e me shku ndër punime të veta gjithkush; për këtë gjë vazhdon verseti:

"Mbasi të kryhet namazi, shpërndanu mbi sipërfaqen e dheut dhe kërkoni nga mirësitë e të Madhit Zot."

Pra të dyja kanë randësitë e veta, e asnjena s'duhet të lehet për tjetrën. Shoqnija njerëzore, vllaznija islame, popullsia e vendit, nuk kanë nevojë vetëm për punë, por kanë nevojë edhe për mbledhje, me u njoftu, me u marrë vesht e me i përgjegjun nevojave të shoqi-shoqit. Prandaj janë ba këto detyrime dhe kanë randsi e dobina të ndryshme. Mirëpo, fatkeqësisht, shumica e madhe asht në tym e në mjegull, nuk interesohet për gjanat më kryesore, nuk mendon sendet shpirtnore, morale e shoqnore; që kështu tue i lanë mbas dore e tue mos ça kryet për ta, po rrotullohen në një jetë ma të keqe se jeta shtazore, saqë po hanë shoqi-shoqin; këtë gjë nuk e bajnë as shtazët, dhe tue qenë në këtë hall e tue e pa veten se çka e ka gjet, prapëseprapë nuk din me u kujtue, s'din me u sjellë kah e mara. E ky mjerim kah i vjen? I vjen prej veprimeve të këqija që e kanë dejë.

Për që myslimani të mbajnë ekuilibrin e kryemjes së detyrave të dy jetëve, dhe që i lypset në çdo çast e në çdo kohë t'i përveshet punës e përpjekjes për sigurimin e lumnisë së kësaj jete e rregullimin e sendeve përkatëse t'asaj të pasosunës, që si na urdhnnon kjo traditë:

"Puno si punon ai njeri që kujton se nuk ka me vdekur kurrë, dhe ki frikë sikur ka frikë ai njeri që trembet se mos vdes nesër."

Pra, me pak fjalë punës kurrë s'duhet me ju da, por gjithmonë lypset me e ndjekë dhe brenda minutit që përpiqemi e jemi t'okupuem me punimin e sigurimit të mirësive të kësaj jete, me mendue edhe jetën e pasosur; e kjo bahet vetëm e vetëm tue qenë njeriu në çdo punë e veprim i sinqertë, i drejtë, i njerëzishëm e fisnik.

Po si mos të jemi punuesa përherë e përpjekësa vazhdimisht kur dihet se edhe i Madhi Profit a.s. s'ka pushue ndonjëherë. Zotnija e tij, urdhrat hyjnore dhe fjalët e veta që i ka folun, që edhe këto janë një lloj revelate, nuk ka mjaftue vetëm me i komunikue e me i lanë në teori, por pikërisht para gjithkujt i ka aplikua vetë në çdo rast e çast të jetës së vet, që kështu ka qenë një simbol i shkëlqyeshëm e shembullor, sikur urdhnnon i Madhi Zot:

"Në personalitetin e Naltë të të dërguemit të Zotit ka simbol të bukur e pasqyrë të qartë për ju."

Këtë të vërtetë e tregon jo vetëm historia islame, por edhe shumë vepra të dijetarëve të ndërgjegjshëm evropian jo-muslimanë, që thonë se i Nalti Muhamed a.s. në jetën e vet, gjithmonë ka qenë veprues në mes të punëve të dynjas e

t'ahiretit. Kur ka qenë koha e adhurimit e ka kalue atë kohë me adhurim; e pastaj asht marrë me punë të tjera, tue u kujdesue për rregullimin e punëve të përgjithshme të myslimanëve, për organizimin e mbrojtjes së vendit që t'i bajt ballë armikut në rast të rrezikut, për përkrahjen e nevojave, për plotësimin e nevojave familjare, e për çdo gjë tjetër; me fjalë të tjera, në çdo çast ka qenë kujdesues për rregullimin e plotë të të gjithë sendeve të nevojshme e të dobishme që i përkasin lumnisë së dy jetëve, si për vete si për gjithë njerëzinë.

Pra nuk ka vend aspak në Islam plogështia, përtacsija, mos përpjekja për punë. Urdhrat fetare janë krejt në kundërshtim me këto veti rrënuese të fatbardhsisë së njerzisë. Prandaj asht një shpifje e madhe dhe turp i pamasë, fjala e atyne që thonë se Islami asht pengues i punës dhe i përparimit. Jo, feja islame përkundrazi, asht luftëtarja ma e rreptë kundrejt papunësis e dekadencës si dhe shkaqeve të tyne. Ata që i thonë këto fjalë, o i thonë nga armiqësija, prej se nuk dinë se çka përmban libri i shenjtë Kur'ani. Cilado qoftë arsyeja, faji asht i madh. Por edhe pse e thonë fes nuk i vjen ndonjë dam. Pse dielli asht diell shkëlqen e ndriçon; e pse i dalin ka një herë përpara ret e zeza, atë nuk e damtojnë e nuk ia zbesin vleftën: asht i naltë, i randësishëm dhe gjithë dobi.

Çdo njeri, mysliman qoftë ose jo mysliman, që e ka studjue fenë islame mirë e me qëllim të pastër e i ka kuptue shpirtin e saj, kurr nuk mund të flasi kundra as më të voglës bazë të saj, por me plot me respekt, detyrohet që të përulet e të gjunjëzohet para madhnis së saj e para Profetit të Madh, Hz. Muhamedit a.s.

Nga gjithë tregimet që u parashtruan më sipër kuptohet qartas se feja islame përveç që asht urdhnuese e punimit dhe e vazhdimit të përpjekjes pa u pra as një herë, por asht edhe themeluesja dhe organizuesja e punës; dhe përbuzëse e madhe e papunësisë e jetës parazitare mbi kurriz të të tjerëve.

Të dëgjojmë një bisedë që ka ndodhur një ditë para të Madhit Profit a.s.

Sahabet (shokët e Profitit) lavdërojnë një njeri në prani të Profetit e i thonë:

"O i dërguemi i Zotit: Akcili agjionon ditën, ban adhurimin natën dhe përmend Zotin shumë."

Iu thotë: "Cili prej jush i siguron ushqimin?"

"Na të gjithë", i përgjigjen.

Mbas kësaj fjale, iu thotë Profiti: "Të gjithë ju jeni ma të mirë se ai".

Kjo fjalë e madhe profetike na jep të kuptojmë se me u marrë vetëm adhurim tue lanë mbas dore punën, me të cilën sigurohet jetesa, nderi, karakteri, burrnija, liria personale, ndihma shoqnore e lumnija kombëtare, nuk numërohet nga virtutet fetare, mbasi feja nuk është vetëm adhurim, por asht dije, urtësi, përparim e naltësim, dhe se këto të gjitha nuk përfitoen veçse me punë, me përpjekje e duke i dhënë randësi kohës, që asht mjeti kryesor i veprimeve e i punimeve.

Hasan Tahsini
Botuar në revistën "Kultura Islame", viti IV, nr. 3-7,
nëntor-mars 1942-1943.





HAFIZ IBRAHIM REPISHTI

(1882-1943)

Hafiz Ibrahim Repishti është një personalitet i shquar i jetës qytetare, politike, shoqërore e fetare në qytetin e tij të lindjes, Shkodër.

Nga një vështrim përgjithësues i jetës dhe i veprimtarisë së Hafiz Ibrahim Repishtit dallohen qartë dy periudha:

Njëra është e ngjeshur me përpjekje të shumta atdhetare, luftarake, politike e shoqërore, gjatë së cilës ai luan një rol tepër aktiv në luftë për mbrojtjen e atdheut kundër sulmeve sllave, në luftë për interesat kombëtare, në përpjekje për themelimin e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij demokratike. Në këtë etapë të jetës ai i shkrin në një kontekst interesat kombëtare me pikëpamjet islame.

Periudha e dytë e veprimtarisë së tij lidhet me idealet dhe moralin e lartë islam. E gjithë përgatitja e tij, dituria dhe përvoja e tij, tashmë drejtohet në këtë objektiv, në përhapjen e besimit islam.

Hafiz Ibrahim Repishti ka lindur në vitin 1882 në lagjen Dudas, në Shkodër. Dudas ishte një lagje me tradita të vjetra islame e njohur edhe për devotshmëri fetare dhe atdhetarizëm. I ati i Hafiz Ibrahim, H. Jusuf Repishti, do të nënshkruante memorandumun e 13 qershorit 1878, dërguar Kongresit të Berlinit, për mbrojtjen e tokave shqiptare. Haxhi Jusufi ishte zgjedhur gjithashtu kryetar i komisionit për financimin e forcave të Lidhjeve të Prizrenit për Shkodrën, komision i cili mblidhte ndihma për ushtrinë vullnetare që të mbronte tokat shqiptare nga ushtritë e Malit të Zi.

Hafiz Ibrahim, duke ndjekur traditën e familjes merr një edukatë të shëndoshë fetare, ndjek mejtepin e njohur të lagjes dhe pastaj vazhdon studimet në Medresenë e Pazarit.

Në vitin 1907 shkon në Stamboll për të ndjekur studimet e larta teologjike dhe diplomohet në shkencën e Sheriatit. Kthehet në vendlindje në vitin 1912.

Në rrethimin e Shkodrës nga forcat malazeze në vitin 1913 u bë një mbrojtje e rrallë nga qytetarët shkodranë me në krye komandant Hasan Riza Pashën. Në radhët e luftëtarëve vullnetarë krahas shumë klerikëve të tjerë myslimanë, u rreshtua edhe Hafiz Ibrahim Repishti. Ai gjithashtu mbulonte pjesën më të madhe të shpenzimeve për ushqimin e vullnetarëve të lagjes Dudas. Për shtatë muaj rresht ai nuk u largua asnjë ditë nga vija mbrojtëse e vullnetarëve.

Me mbarimin e luftës Hafiz Ibrahim Repishti angazhohet në veprimtarinë arsimore. Kështu krijohet këshilli i ri arsimor pranë Bashkisë. Kryetari i parë i këtij këshilli ka qenë kadiu i Shkodrës, Xhemal Naipi. Pastaj Hafiz Hysejn Vuthi e në shtator 1919, Hafiz Ibrahim Repishti. Anëtarët e këtij këshilli ishin personalitete të shquara si: Hafiz Abaz Golemi, drejtor i shkollës së Parrucës, At Gjergj Fishta, drejtor i shkollës së Fretërve, Gaspër Mikeli, drejtor i shkollës popullore, Hafiz Hysejn Vuthi, drejtor i shkollës Rus Haslikaj, Sheuqet Muka, etj.

Si kryetar i këtij këshilli arsimor, ai do të luajë një rol me

rëndësi për arsimimin e bijve të qytetit të Shkodrës. Një rëndësi të veçantë i kushton edhe mësimin të besimit në shkollat e shtetit. Në arkivin e Muzeut të Shkodrës ka një dokumentacion të pasur lidhur me këtë problem.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore dhe krijimin e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, ai përkrah këtë lëvizje duke bërë të mundur zhvillimin e disa mbledhjeve të këtij komiteti në shtëpinë e tij.

Hafiz Ibrahim Repishti vazhdoi pandërprerë të punonte për atdheun dhe për fenë si dhe pasuroi bibliotekën e trashëguar nga i ati duke e bërë një nga më të mirat në qytet.

Në luftën politike në vitet 1920-24, Hafiz Ibrahim Repishti zë një vend të veçantë. Në votimet e dhjetorit 1923 Hafiz Ibrahim zgjidhet përfaqësues i qytetit të Shkodrës, anëtar i Asamblesë Kushtetuese e më vonë deputet.

Gjatë qëndrimit të tij në Parlament ka kryer funksionet e nënkryetarit të komisionit parlamentar për jurisprudencë dhe të komisionit parlamentar për arsimin. Delegacioni parlamentar i Shkodrës përfshinte klerikë katolikë dhe myslimanë si: At Gjergj Fishta dhe Hafiz Ibrahim Repishti.

Hafiz Ibrahim në shënimet e tij biografike do të vinte theksin te kjo harmoni ndërfaqë, e cila ishte e rrallë dhe unike për të gjithë Ballkanin e atyre viteve.

Ai ka qenë pjesë e qeverisë së Nolit dhe pas shpalljes së Monarkisë në Shqipëri tërhiqet nga jeta politike. Kështu, nga viti 1925 deri në vitin 1943 ka shërbyer si imam i xhamisë së Dudasit, duke iu përkushtuar tërësisht jetës fetare dhe edukimit të banorëve me besimin në Zotin dhe me moralin e lartë islam. Ai dinte disa gjuhë të huaja dhe shfrytëzonte rregullisht bibliotekën e tij të pasur.

Pas vitit 1925 ai ka qenë gjithashtu mësues për shumë të rinj që i ishin përkushtuar studimeve islame. Sipas familjarëve, Hafiz Ibrahim ka shkruar mjaft artikuj në revista të ndryshme të Egjiptit dhe Marokut.

Hafiz Ibrahim Repishti, si një qytetar i mbujtur me idealet më të larta atdhetare e demokratike, si një imam i shquar i pajisur me cilësi të larta morale e fetare, bëri që me pushtimin fashist të 1939, të gjendej kundërshtar i këtij pushtimi. Lidhur me këtë, i biri, prof. Sami Repishti, në librin e tij "Pika loti", shpjegon bastisjen dhe torturat e fashistëve në shtëpinë e tyre gjatë një nate të errët, tortura të cilat sollën hemorragji cerebrale dhe shkaktuan ndërrimin jetë pas dy javësh, 29 shtator 1943, të Hafiz Ibrahim Repishtit.

Familja e tij u ndoq dhe u persekutua edhe nga regjimi komunist, të cilat prof. Sami Repishti i ka shpjeguar në tregimet dhe librat e tij.

Hafiz Ibrahim Repishti si demokrat, si atdhetar dhe si fetar, la një emër të nderuar në të gjithë plejadën e ndritur të hoxhallarëve të shquar të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë.¹

¹ Luli, Faik; Dizdari, Islam; Bushati, Nexhmi, "Në kujtim të brezave", Rozafat, 1997: 263-280.

FËMIJËT DHE NAMAZI



Padyshim që namazi përbën adhurimin unik ku ne shpalosim përvulljen dhe devotshmërinë tonë ndaj Krijuesit. Është adhurimi më efektiv dhe më mbresëlënës përse i përket përkushtimit ndaj Zotit të gjithësisë. Porë nga ky këndvështrim, namazi duhet shikuar me një sy të ndjeshëm dhe të tregohet shumë kujdes në realizimin e tij.

Të mësuarit e fëmijëve tanë me namaz sigurisht që fillohet në familje, nëna dhe babai janë personat e parë që ndikojnë në krijimin e një zakoni të tillë te fëmija. Pikë së pari ai duhet të shohë nënën dhe babain duke falur namaz sepse njeriu ka ardhur në këtë botë për t'u pajisur me dije dhe lutje. Porë nga natyra dhe aftësia e njeriut, çdo gjë lidhet me dijen dhe informimin. Pra çdo njeri meson diçka duke u bazuar në një model të mëparshëm dhe në informacionin e marrë. Ai mund të bëhet besimtar apo armik i fesë, vrasës apo vjedhës duke u ndikuar nga ambjenti përreth duke filluar nga nëna e babai e më pas nga edukimi i marrë.

Një nga psikologët e njohur John B. Watson thotë: "Më jepni një fëmijë dhe të gjithë informacionin e duhur në lidhje me të si prejardhja, aftësitë, prirjet, etj., dhe më pas unë do ta bëj atë një doktor, avokat, tregtar, madje edhe një vjedhës apo vrasës."

Siç e shihni ne e kemi në dorë t'u japim fëmijëve tanë zakonet dhe sjelljet e dëshiruara nga ne.

Edukimi me namaz sipas moshës

Në edukimin e fëmijëve një rol të rëndësishëm luan dhe faktori moshë, kur dhe si do t'ja mësojmë. Edukimi i dhënë një fëmije të moshës shtatë vjeç nuk është i njëjtë me edukimin që i jepet një fëmije të moshës dhjetë dhe nuk duhet të jetë.

Të rinjtë dhe namazi

Nëse keni një fëmijë adoleshent atëherë duhet të përdorni metodat e bindjes dhe ngrohjes me namazin në vend të frikësimit apo detyrimit të vazhdueshëm. Në periudhën e adoleshencës të rinjtë kanë tendencën të bëjnë të kundërtën e asaj që urdhërojnë prindërit për të aprovuar personalitetin dhe pavarësinë e tyre. Nisur nga ky fakt ndonjëherë kur përpiqesh t'ja bësh sa më të dashur e të bukur namazin përballësh me një rezistencë dhe kundërshtim të fortë. Sigurisht që qëndrimi larg adhurimeve i fëmijëve të rritur nga prindër besimtarë mund të lidhet edhe me qëndrimin e mbajtur nga vetë prindërit.

Për këtë arsye duhet të jemi sa më mirëkuptues dhe të durueshëm para tyre në mënyrë që të ndihen të sigurtë dhe të pasqyrojnë veten e tyre ashtu siç janë në të vërtetë. Nëse adoleshenti e kupton që pranohet nga familja bashkë me personalitetin e tij atëherë do të tregohet më mirëkuptues para kryerjes së adhurimeve të ndryshme si namazi e të tjera.

Namazi dhe shoqëria

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në sjelljet e adoleshentit është shoqëria dhe sjelljet e shokëve apo shoqeve. Në këtë periudhë adoleshentët priren t'u ngjasojnë më shumë shokëve sesa prindërve sepse me ato kanë më shumë pika të përbashkëta. Bazuar në këtë fakt fëmijët tanë mund t'i prezantojmë me shokë familjet e të cilëve praktikojnë namazin .

Para se të duan namazin fëmijët duhet të duan Krijuesin e gjithësisë. Prandaj Zotin duhet ta njohin me emrat më të dashur si i Mëshirshmi, Dhuruesi i mirësive, Mbrojtësi e jo dënuesi apo kërcënuesi. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë fjalët e çmuara të Hz.Omerit (r.a), i cili thotë: "E dua të moshuarin kur fal namaz, ama e dashuroj të riun kur e fal atë."

Të jesh model i mirë

Mënyra më e mirë për t'u mësuar fëmijëve tanë zakone të mira e të shëndetshme është të bëhemi një model, udhërrëfyes për ta. Duke treguar kujdes për kohët e namazit , mënyrën e faljes së tij dhe në përshtatje me shpirtin e namazit do të krijojmë para fëmijëve një model të çmuar dhe të pazëvendësueshëm. Përgatitja juaj për namaz dhe qetësia e ndërë gjatë faljes së tij do të ketë efektin e vet tek fëmijët. Ndoshta sot nuk do ta ndiejmë por në të ardhmen do ta vëmë re që kjo do të përbëjë një pasuri të vyer në botën shpirtërore të fëmijës.

Forcimi i besimit është një rrugë e cila lehtëson praktikimin e namazit e adhurimeve të tjera. Prandaj është shumë e rëndësishme të lexojmë familjarisht vepra të cilat nxisin dhe forcojnë besimin tone. Këshillat dhe biseda nuk duhet të jetë e drejtpërdrejtë për namazin apo çështjet e tij sepse një njeri i cili nuk fal namaz mund të reagojë në të kundërt nëse e kupton mesazhin e qëllimin e bisedës.

Mangësitë në faljen e namazit mund të lidhen me dembelizimin, filmat, median sociale, lojërat kompjuterike apo të shikuarit e tepruar të programeve të ndryshme televizive apo ndeshjeve të futbollit. Nëse besimtari nuk ndjen kënaqësi gjatë faljes së namazit i cili përbën ushqimin e zemrës e shpirtit atëherë kjo tregon drejtimin e tij në gjëra të tjera .

Nisur nga ky fakt e mira është të minimizojmë kohën e kaluar me gjëra të pavlefshme , të mësojmë të përdorim kohën në mënyrën e duhur dhe t'i japim namazit rëndësinë e merituar.

Të mos harrojmë të fshehtën dhe misterin e lutjes, duhet të lutemi shumë për fëmijët tanë. "Zoti im më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që falin namazin dhe pranojnë lutjen time o Zoti ynë."(Ibrahim, 40)

Amin!

GOGËSITJA

NJË SINJAL MISTERIOZ

Njeriu është krijuar për të njohur dhe kuptuar realitetin që e rrethon dhe për të qenë i vetëdijshëm për të. Ne i kuptojmë ngjarjet që ndodhin rreth dhe brenda nesh nëpërmjet sinjaleve që lëshon organizmi ynë. Çdo gjallesë ka një gjuhë të vetën të trupit dhe, duke lëshuar sinjale si teshtima, të dridhura apo gogësitja, ajo shpreh një gjendje të caktuar.

Është shumë e rëndësishme të dëgjohet kjo gjuhë dhe t'i kushtohet vëmendje në mënyrë që të merren masa për të parandaluar sëmundje ose çrregullime të ndryshme. Për shembull, kur dikush ka ftohtë duhet të ngrohet, kur është i inatosur duhet të qetësohet, kur është i lodhur duhet të pushojë etj.

Gogësitja është një nga sinjalet kryesore të trupit tonë. Ajo fillon që në barkun e nënës dhe vazhdon përgjatë gjithë jetës. Ajo nxitet nga shkaqe si lodhja, mungesa e motivimit, mërzitja, dëgjimi i diçkaje monotone, të qenët në një ambient të paoksigjenuar, duke parë një person tjetër që gogësin, mungesa e gjumit ose nga shkaqe patologjike si epilepsia, infeksione të trurit, sëmundje vaskulare të trurit dhe tumore të tij.

Disa substanca janë përgjegjëse për transmetimin e sinjaleve nervore që nxisin gogësitjen, ndërsa disa të tjera për frenimin e saj. Për shembull, kur nivelet e endorfinave rriten, gogësitja frenohet, ndërsa kur nivelet e dopaminës dhe serotoninës rriten, gogësitja nxitet. Disa medikamente gjithashtu mund

të nxisin gogësitjen. Edhe gogësitja e vazhdueshme ose kronike, gogësitja jo e plotë ose pamundësia për të gogësitur konsiderohen jo normale dhe simptoma të sëmundjeve të ndryshme.

Është një fakt tashmë i ditur se personi që përpiket të qëndrojë zgjuar gogësin më shumë se një person që është përgjumësh. Përderisa gjatë gogësitjes rrahjet e zemrës rriten dhe frymëmarrja po ashtu, atëherë sasia e gjakut dhe oksigjenit që i dërgohet trurit është më e madhe. Përderisa truri është organi që ka më shumë nevojë për oksigjen se çdo organ tjetër, funksioni i tij përmirësohet gjatë gogësitjes.

Gjatë gjumit njeriu rifreskon trupin nga stresi dhe lodhja. Gogësitja është një sinjal alarmi që i tregon trupit tonë se duhet të pushojë. Nëse një person nuk bën gjumë aq sa duhet, atëherë ai ka ulje të përqendrimit, bëhet nervoz dhe gogësin shpesh. Për më tepër, veshjet sintetike dhe këpucët prej gome janë ndër shkaqet që çojnë në gogësitje të shpeshtë, sepse izolojnë trupin elektrikisht dhe nuk e lejojnë të shkarkohet. Kjo ngarkesë elektrike e grumbulluar çon në stres dhe lodhje të parakohshme duke nxitur gogësitjen.

Në një studim u tregua se persona të ndryshëm kanë referenca të ndryshme gjatë ditës sa i përket gogësitjes. 75% e njerëzve gogësin në mëngjes, 50% në fund të ditës, 30% pas vakteve të të ngrënit dhe 47% kur shtrihen. Shkencëtarët gjithashtu zbuluan një

lidhje ndërmjet gogësitjes dhe temperaturës së trurit. U vu re se gogësitja frenohej kur personi merrte frymë me hundë, gjë e cila ftohet temperaturën e trurit në zonën e ballit. Në këtë aspekt, truri i ngjan një kompjuteri, i cili punon më mirë kur ftohet. Vetë gogësitja e ftohet trurin duke e ndihmuar atë të punojë në mënyrë më efektive, ashtu si një kompjuter punon më mirë kur ventilatori punon mirë. Lodhja dhe pagjumësia nxisin gogësitje sepse ato rrisin temperaturën e trurit.

Ka edhe faktorë të tjerë që nxisin gogësitjen, si pirja e tepruar e kafesë dhe çajit, të cilët kanë stimulues nervorë, e nxisin trurin të konsumojë më shumë energji. Për pasojë edhe gjumi pengohet, temperatura rritet nga puna e tepërt dhe ndodh gogësitja. Dehidratimi gjithashtu është shkak i gogësitjes, për pasojë ekspertët rekomandojnë pirjen e lëngjeve rregullisht. Bërja e një banje me ujë të nxehtë gjithashtu nxit gogësitjen sepse stimulon prodhimin e hormoneve që japin gjumë. Prandaj rekomandohet që të bëhet banjë në darkë dhe jo në mëngjes, për arsye se personi rrezikon të përgjimet gjatë ditës. Edhe të folurit me telefon celular për një kohë të gjatë e lodh trurin dhe nxit gogësitjen.

Gogësitja nxitet edhe nga konsumimi i pijeve acidike pa kriter, nga ekspozimi në zhurma të mëdha për një kohë të gjatë, gjatë stërmundimit ose nga ekspozimi në dritë fluoeshente për kohë të gjatë.

Hipotalamusi dhe gogësitja

Hipotalamusi është një pjesë shumë e rëndësishme e trurit, i cili gjendet në pjesën e poshtme të tij. Ai formon lidhje dhe kontrollon funksionin e hipofizës, e cila nga ana tjetër kontrollon sistemin endokrin përmes gjëndrave që prodhojnë hormonet përkatëse. Ndër funksionet e tjera të tij janë kontrolli i emocioneve, i agresivitetit, urisë, etjes, gjumit, presionit të gjakut dhe temperaturës trupore. Trupi përgjigjet ndaj këtyre problemeve duke gogësitur. Për shembull, në rastet kur kërkesat e organizmit për oksigjen janë të rritura, hipotalamusi nxit mushkëritë që të marrin frymë më shumë dhe personi gogësin. Për këtë arsye, mund të thuhet se qendra përgjegjëse për gogësitjen besohet të jetë e lokalizuar në hipotalamus.

A është gogësitja ngjithëse?

Gogësitja është ngjithëse, ashtu siç është edhe e qeshura. Tashmë është e ditur se një

person gogësin kur sheh, dëgjon apo mendon ose lexon për një person tjetër duke gogësitur. Një psikolog vuri re, duke bërë një eksperiment me studentët e tij, se kur ata panë dikë duke gogësitur, 50% e tyre filluan të gogësinë pas disa minutash. Ekspertët kanë thënë se ngjitja e gogësitjes ka të bëjë me ndjenjën e empatisë ndërmjet njerëzve dhe është një formë refleksi.

Shprehja e fytyrës së personave që gogësinë mendohet se ka efekt mbi një person që po i vëzhgon ata dhe kjo nxit gogësitjen. Kjo ndodh kur aktivizohen neuronet pasqyrë, të cilat stimulojnë te një person ato gjëra që ai vëzhgon te dikush tjetër.

Neuronet pasqyrë janë qeliza të cilat ndikohen nga vëzhgimi i sjelljeve të caktuara të anëtarëve, sidomos ndërmjet vertebrorëve të të njëjtit lloj. Është vënë re, se te fëmijët nën moshën 5 vjeç nuk ndodh gogësitja kur ata shikojnë dikë tjetër të gogësinë, sepse tek ata neuronet pasqyrë nuk janë zhvilluar ende plotësisht dhe ndjenja e empatisë nuk ekziston. Zonat e trurit përgjegjëse për empatinë dhe gogësitjen janë të njëjta. Sidoqoftë, te disa persona që nuk ndikohen nga gogësitja këto zona janë inaktive. Prandaj, gogësitja është më e theksuar te personat që kanë më të zhvilluar ndjenjën e empatisë.

Gogësitja dhe larja

Trupi i njeriut ka një ekuilibër elektrostatisht të vetin. Mbajtja e këtij ekuilibri konstant është jetike për shëndetin tonë. Gogësitja është një simptomë e rëndësishme që tregon për sëmundje psikosomatike që mund ta prishin këtë ekuilibër. Kontakti me ujë ose dheun është një mënyrë me të cilën organizmi ynë rregullon këtë ngarkesë elektrostatisht të brendshme. Kjo shpjegon pse marrja e abdesit ose e guslit e rinfreskon lëkurën dhe sistemin nervor, duke ndihmuar rivendosjen e këtij ekuilibri. Në rastin e abdesit, personi lag pjesët më ekstreme të trupit, aty ku ngarkesat elektrostatisht mblidhen më së shumti gjatë ditës, duke ndihmuar që këto të shkarkohen nëpërmjet ujit ose gjatë faljes së namazit, kur personi bie në sexhde në kontakt me tokën.

Përktheu: Erion Sukaj

Rëndësia e Motivimit

Për të ishte hera e parë që jepte mësim në atë klasë. Gjatë orës së mësimi i drejtoi një pyetje njërit prej nxënësve. E gjitha klasa shpërtheu në të qeshura.

U çudit nga ai reagim, pasi nuk kishte asnjë arsye për të qeshur. Falë vështirimeve të nxënësve, kuptoi se kishte pyetur nxënësin më të dobët të klasës, atë që e njihnin për tapë-topi.

Kur nxënësit dolën, mësuesja i kërkoi nxënësit që konsiderohej më i dobët që ta priste pak. Ajo i shkroi një poezi në një letër dhe duke ia zgjatur, i tha: "Dua që këto vargje t'i mësosh njëllonj siç ke mësuar emrin tënd dhe të mos i tregosh askujt për këtë. Mirë?!" Nxënësi pohoi me kokë, mori letrën dhe u largua i habitur.

Të nesërmen, mësuesja e re shkroi vargjet në dërrasë dhe pasi i analizoi, i fshiu. Pastaj pyeti nxënësit: "Kush nga ju e mësoi poezinë përmendësh nga dërrasa e zezë, të ngrejë dorën!"

Askush nuk e ngriti dorën, përveç nxënësit që konsiderohej i dobët. Edhe pse dinte, ai e ngriti dorën tërë frikë e hezitim. Mësuesja, duke i buzëqeshur, i tha: "Po, na e recito!"

Me fjalë që mezi i dilnin nga goja, ai e recitoi poezinë që e kishte mësuar paraprakisht. Mësuesja e vlerësoi dhe i shprehu fjalë motivuese para të gjithë nxënësve, madje kërkoi që ta duartrokisnin.

Nxënësit, të shushatur nga ajo që kishte ndodhur, e duartrokitën dhe e përgëzuan.

E njëjta gjë u përsërit disa herë gjatë javës, por me forma të ndryshme, e sigurisht, u

përsëritën dhe fjalët e mira, konsideratat, lëvdatat, vlerësimet, por edhe duartrokitjet gjithë zell të shokëve e shoqeve të klasës.

Paralelisht me përmirësimin e tij, filloi të ndryshojë dhe konsiderata e nxënësve të tjerë kundrejt shokut të tyre.

Ai vetë filloi të forcojë besimin te vetja, filloi të kuptojë se nuk ishte idiot, apo hu gardhi dhe tapë-topi, siç e kishin etiketuar mësuesit e tjerë, por edhe shokët e shoqet e klasës. Filloi të kuptojë që edhe ai mund të mësonte dhe të përgjigjej si gjithë të tjerët.

Afroi data e provimeve përfundimtare. Lexoi, përsëriti dhe i mori të gjitha lëndët.

Hyri në shkollë të mesme gjithë zell e vullnet. Çdo vit i përmirësoheshin rezultatet. Arriti mesataren për të ndjekur studimet universitare.

E përfundoi fakultetin me rezultate të larta. Studioi master dhe sot ndjek doktoraturën.

Është historia e një studenti, e rrëfyer nga ai vetë në gazetën e universitetit.

Njerëzit janë dy llojesh:

Ose çelës i së mirës dhe kyç i së keqes, duke nxitur, motivuar, zgjatur dorën, mbushur me shpresë e duke dhënë optimizëm;

Ose kyç i së mirës dhe çelës i së keqes, demoralizues, pengues, vënës shkopinjsh nën rrota, tallës, ironizues, fajësues.

Nxënësi i mësipërm ishte viktimë e llojit të dytë, por në një moment të jetës, u gjend përballë një njeriu nga lloji i parë, i cili i ndryshoi jetën.



Haxhi 5800€



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË ORGANIZON HAXHIN 2023

PËRFSHIHEN:

- ✓ Transporti ajror vajtje-ardhje.
- ✓ Transporti me autobus në Mekë dhe Medine.
- ✓ Akomodimi në hotele.
- ✓ Ushqimi: Mëngjes, drekë, darkë.
- ✓ Kurhani, ujë zemzemi, numra telefoni.
- ✓ Shoqërimi nga teologë dhe mjekë përgjatë gjithë ritualit.

DOKUMENTET E NEVOJSHME:

- ✓ Pasaporta e vlefshme jo më pak se 1 vit. Ndërsa personat që nuk kanë nënshtetësi shqiptare, duhet të paraqesin lejen e qëndrimit, me afat vlefshmërie jo më pak se 6 muaj.
- ✓ Fotografi pasaporte.
- ✓ Vaksina kundër meningjitit, me afat jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se tre vjet.

REGJISTROHUNI PRANË KMSH-SË OSE PRANË MYFTINISË SË QYTETIT
TUAJ DERI MË **07 MAJ 2023**



Rr. "George.W. Bush"
Nr. 50, Tirana/Albania



www.kmsh.al
haxhi@kmsh.al



+355 696801100